



FAKULTETI JURIDIK
FACULTY OF LAW

STUDIME POSDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

DREJTIMI: CIVIL

TEZA:

**“SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË ME
THEKS TË VEÇANTË NË TERRITORIN E GJYKATËS THEMELORE
SHKUPI 2-SHKUP, NGA VITI 2015 E KËNDEJ”**

Kandidati:

Izaim Halimi

Nr.ID:122251

Mentori:

Prof.dr.Adnan Jashari

Studimet posdiplomike

Tetovë

2019

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT.....	4
FALENDERIME.....	5
HYRJE.....	5

KAPITULLI I

IKUSHTET E PËRGJEGJËSIS PËR DËMIN E SHKAKTUAR7

1. Dëmi.....	8
1.1. Llojet e demit.....	9
1.1.1. Dëmi material.....	9
- Dëmi i vërtet (damnum emergens).....	10
- Fitimi i munguar (lucrum cessans).....	11
- Dëmi konkret.....	12
- Dëmi abstrakt.....	12
- Dëmi i drejtpërdrejtë.....	12
- Dëmi jo i drejtpërdrejtë.....	13
- Dëmi efektiv dhe dëmi i ardhshëm.....	13
- Dëmi i parapar dhe dëmi i papaparar.....	13
1.1.2. Dëmi jomaterial.....	14
2. Aftësia Deliktore.....	15
2.1. Aftësia deliktore e personave fizik.....	16
2.2.2. Aftësia deliktore e personave juridik.....	17
3. Lidhja kauzale.....	17
4. Veprimi i kundërligjshëm.....	20
4.1. Përfundimi i veprimit të kundërligjshëm.....	22
5. Faji.....	26
5.1. Shkallët e fajit.....	27

KAPITULLI II

II. NË PËRGJITHËSI PËR SHPËRBLIMIN E DËMIT.....30

2.1. Nocioni i shpërblimit të dëmit... ..	30
2.2. Qëllimi i shpërblimit të dëmit.....	32
2.3. Shpërblimi i dëmit material.....	35
2.3.1. Dëmshpërblimi në natyrë.....	36
2.3.2. Shpërblimi i dëmit në para.....	37
2.4. Kriteret për caktimin e lartësis së dëmshpërblimit.....	39
2.5. Rastet e veçanta të shpërblimit të dëmit material.....	41

KAPITULLI III

III. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL.....	44
3.1. Kuptimi i dëmit jomaterial.....	44
3.1.1. Kushtet e dëmit.....	47
3.2. Ekzistimi i dëmit.....	48
3.3. Faji.....	49
3.4. Ekzistimi i dhembjeve.....	50
3.5. Realizimi i shpërblimit të dëmit.....	51
3.5.1. Kërkesa për shpërblim të dëmit.....	52
3.5.2. Parashkrimi i kërkesës për shpërblim të dëmit.....	52
3.5.3. Vendimi mbi shpërblimin e dëmit.....	54

KAPITULLI IV

IV.RASTET E SHPËRBLIMIT TË DËMIT JOMATERIAL.....	56
1.Shpërblimi i dëmit jomaterial në vitin 2015.....	56
2.Shpërblimi i dëmit jomaterial në vitin 2016.....	60
3.Shpërblimi i dëmit jomaterial në vitin 2017.....	63
4.Shpërblimi i dëmit jomaterial në vitin 2018.....	66
5.Dëmshpërblimi varësisht nga shkaku të dëmi jomaterial nga viti: 2015, 2016, 2017, 2018.....	71
6.Mënyrat e dëmshpërblimit të dëmit jomaterial nga vendimet e analizuara gjyqësore nga viti: 2015, 2016, 2017, 2018.....	71
7.Përfundimi.....	72
8.Bibliografia.....	75

Abstrakt

Rregullat juridike civile për shpërblimin e dëmit, përveç se në dispozitat e ligjit për marrëdhënie të detyrimeve të Maqedonisë, i hasim edhe në dispozitat tjera normative. Me rastin e shkaktimit të dëmit, si rregull për subjektin përgjegjës lind detyrimi për shpërblimin e dëmit. Kurse, për palën të cilës i është cënuar një e drejtë e karakterit pasuror apo personal, gjithmonë lind e drejta për të kërkuar riparimin e situatës së krijuar apo shpërblimin e dëmit. Shpërblimit të dëmit si rregull i paraprinë fakti i shkaktimit të dëmit. Dëmi mund të shkaktohet nga njerëzit, si edhe nga sendet e rrezikshme dhe veprimtaritë e rrezikshme. Shkaktuesi i dëmit përgjigjet ose në bazë të rregullave të përgjegjësisë subjektive, ose në bazë të rregullave të përgjegjësisë pa faj, objektive. Në rast të lindjes së përgjegjësisë subjektive, autori i dëmit duhet të ketë aftësi deliktore, të ketë faj dhe veprimi i tij të jetë në kundërshtim me rregullativën ligjore. Kurse te përgjegjësia objektive, duhet që dëmi të shkaktohet nga përdorimi i sendeve të rrezikshme apo veprimtarive të rrezikshme.

E drejta për shpërblim të dëmit realizohet kryesisht në procedurë gjyqësore. Procedura inicohet vetëm me anë të parashtrimit të padisë nga i dëmtuari, me të cilën paraqitet kërkesa konkrete në pikëpamje të shpërblimit të dëmit, faktet ku mbështetet kërkesa, provat dhe vlera e kontestit.

Abstract

Rules of civil law for damages except in the provisions of the law liabilities relationship of Macedonia are noticed as well in the provisions of other laws. In case of damage being caused, as a rule of the subject responsible for damage compensation liability arises and which side has infringing a right of property damage or personal character, always arises the right to seek repairs situation created or reward damage. Compensation for damage as a rule precedes the fact of causing harm. The damage can be caused as by the people, as well as from dangerous things and dangerous activities. Guilty of damage either responses on the basis of subjective liability rules or under the rules of liability without fault objective. In case of the birth of subjective responsibility, damager must have delinquent capability fault and the action to be in violation of legal regulations, and objective responsibility the damage is caused by the use of dangerous items or dangerous activities.

The right for compensation of damage is done mainly in court procedure. The procedure is initiated only by the lawsuit by the injured party which presented specific requirements in terms of compensation for the damage, the facts supporting the claim, the evidence and the value of the contest.

Falenderime

Me shumë kënaqësi po shpreh falenderimet e mia për të gjithë ata që më ndihmuan, konsultuan dhe më mbështetën moralisht gjatë realizimit të tezës së masterit “Shpërblimi i dëmit jomateria; në Republikën e Maqedonisë me theksë të veçantë në territorin e gjykatës themelore Shkupi2-Shkupi, nga viti 2015 e këndej”. Së pari falënderoj udhëheqësin e këtij punimi Prof.dr.Adnan Jashari për kohën, durimin dhe mirëkuptimin e tij.

Një falënderim të veçantë edhe për familjen time, për qëndrime koherente të shfaqura në përkrahje të realizimit të synimeve të mia profesionale, edhe përkundër faktit që ju kam munguar në shumë momente të bukura, por gjithmonë të vetëdijshëm dhe të mirëkuptueshëm për mundin që duhet për të realizuar një punim të këtij niveli.

Hyrje

Shkaktimi i dëmit paraqet burim të detyrimeve juridike civile. Dëmi mund të shkaktohet me veprim ose mosveprim. Dëmi mund të shkaktohet edhe prej sendeve të rrezikshme dhe veprimtarisë së rrezikshme si dhe nga ngjarjet e ndryshme natyrore. Në të gjitha rastet kur shkaktohet dëmi, për të drejtën lind një fakt relevant juridik, mbi bazën e të cilit lind edhe përgjegjësia juridike civile.

Hulumtimet e viteve të fundit dëshmojnë se dëmet e shkaktuara nga njeriu, nga ngjarjet natyrore ose nga sendet e rrezikshme dhe veprimtaritë e rrezikshme shpeshherë mund të jenë me pasoja shumë të mëdha në njerëz dhe në pasuri. Andaj, duke marrë për bazë këto rrethana dëmtuese dhe me pasoja tepër të mëdha për shoqërinë, kam menduar që rregullat e shkaktimit të dëmit t'i trajtoj në mënyrë më të thelluar edhe për faktin se këto rrethana përcaktojnë bazën e përgjegjësisë për subjektin përgjegjës, për të cilin lind detyrimi që të zhdëmtojë palën e dëmtuar. Edhe pse Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve të Maqedonisë rregullon çështjen e shkaktimit të dëmit dhe shpërblimit të tij, në nenet 141-198, prapëseprapë kjo nuk mjafton që me këto të përfshihen dhe shumë situata të tjera që ndodhin

në praktikë. Prandaj, çështjet e lindjes së përgjegjësisë civile nga shkaktimi i dëmit i hasim edhe nëpër dispozita të ligjeve tjera, bazuar në konventa të ndryshme ndërkombëtare.

Për të ekzistuar marrëdhënia juridike e shkaktimit të dëmit duhet të plotësohen kushtet për ekzistimin e dëmit dhe kushtet për lindjen e përgjegjësisë civile për kompensim dëmi (ekzistenca e dëmit është primare për lindjen e përgjegjësisë si element sekondar). Për ekzistimin e kësaj marrëdhënie juridike duhet që dëmi të jetë shkaktuar nga ndonjëri prej subjekteve të së drejtës, dmth nga personat fizik dhe personat juridik.

Sot, teoria edhe legjislacioni civil dallon dëmin pasuror – material dhe atë jopasuror – jomaterial. Dëmi pasuror shkakton si pasojë cenimin e pasurisë së të dëmtuarit në kuptimin e ngushtë ekonomik, pra humbjen e pasurisë në mënyrë të paligjshme. Prandaj, edhe dëmshpërblimi i dëmit pasuror ka për qëllim të rikthejë pasurinë e të dëmtuarit në gjendjen e mëparshme, duke “mbushur” diferencën e krijuar ndërmjet gjendjes ekonomike aktuale të tij, me atë në të cilin do të ndodhej nëse nuk vërtetohej fakti i paligjshëm.

Mbrojtja e të drejtave subjektive civile me rastin e shkaktimit të dëmit përfshinë njohjen e së drejtës për shpërblim të dëmit dhe rivendosjen e gjendjes që ekziston para cenimit të së drejtës së caktuar. Në këtë rast, midis dëmtuesit dhe të dëmtuarit lind një marrëdhënie juridike civile me të drejta dhe detyrime konkretë për palët në fjalë. Realizimi i detyrimit të shpërblimit të dëmit bëhet në kuadër të një procedure të caktuar ligjore. Procedura mund të jetë e natyrës administrative dhe asaj gjyqësore. Zbatimi i detyrimit për shpërblim të dëmit nga organi i autorizuar është në funksion të kënaqjes së interesit të personit të dëmtuar - të mbrojtur nga ligji.

KAPITULLI I

I. KUSHTET E PËRGJEGJËSIS PËR DËMIN E SHKAKTUAR

Për të ekzistuar përgjegjësia për dëmin e shkaktuar duhet të plotësohen disa kushte konkrete siç janë: dëmi, aftësia deliktore, lidhja kauzale, veprimi i ndaluar dhe faji. Të gjithë këto kushte duhet të plotësohen në mënyrë komulative.

Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar aplikohet në një fushë të gjerë të jetës së përditshme. Krijohet me sjellje ose veprime të personit të caktuar i cili me ato veprime ndërmer diçka si bërje e ndonjë veprimi konkret ose mos bërje. Përgjegjësitet për dëmin e shkaktuar janë përgjegjësia kontraktore dhe jokontraktore apo deliktore. Përgjegjësia kontraktore krijohet atëher kur nuk përmbushet detyrimi i parapar në marveshje ose përmbushja e saj nuk bëhet në mënyr të plotë.

Psh. si kriteret në bazë të të cilave përcaktohet mospërmbushja e detyrimeve kryesore të shitësit merren:

- a) Vonesa në dërgimin e mallit;
- b) Mospërputhja e cilsive kualitative dhe kuantitative të mallit të dërguar me ato të kontraktuara.

Vonesa në mos dërgimin e mallit. Shitësi konsiderohet se është vonuar në dërgimin e mallit në rastet kur ai nuk dërgon mallin në afatin e kontraktuar ose në afatin e rëndomtë.

Mospërputhja e cilsive kualitative dhe kuantitative të mallit të dërguar me ato të kontraktuara. Konsiderohet se shitësi nuk i ka përmbushur detyrimet edhe në rastin kur ai dorëzon mallrat të cilësive kualitative dhe kuantitative të ndryshme nga ato të përmenduarat në kontratë.¹ Mos ekzekutimi i kësaj marveshje personin përgjegjës e detyron të shpërblej palën tjetër që është e dëmtuar në këtë rast, pra detyrë kryesore të përgjegjësia kontraktore është që detori të përmbush kontratën. Përgjegjësia deliktore krijohet me vet faktin e shkaktimit të deliktit edhe pse në këtë fushë ekzistoj rregulla të përgjithshme që subjektet duhet të

¹ A.Jashari, E drejta afariste kontraktore, Tetovë, 2016, faqe. 120, 121.

përmbahen nga veprimet që mund ti shkaktojnë dëm tjetrit por përsëri ka raste kur me veprimet deliktore i shkaktojnë dëm personit tjetër.²

Si kushtë i përgjithshëm dhe i pranishëm për përgjegjësin e dëmit të shkaktuar, është e nevojshme që dëmi të jetë shkakuar me veprime konkrete qoftë të bëra ose të pa bëra.

Rregullat e shkakimit të dëmit janë të shumta dhe të shumëllojshme që kanë filluar të zbatohen që në të drejtat më të vjetra e deri në të drejtën bashkëkohore dhe në bazë të argumenteve supozohet se këto të drejta do të jenë deri sa të ekzistojnë njeriu. Nisma e rregullave të shkakimit të dëmit është që nga kohërat e vjetra të cilat rregulla kanë qenë primitive dhe abstrakte deri në rregullat bashkëkohore të specializuara dhe të zhvilluara në numër më të madhë krahas atyre rregullave të vjetra. Dëmi mund të shkaktohet në mënyra të ndryshme, qoftë nga personat fizik apo juridik që janë subjekt potencial për shkakimin e dëmit, duke bërë ndonjë veprim të caktuar ose kur nuk ndërmarin asnjë veprim për të cilin është dashur të ndërmirret që të mos shkaktohet dëmi. Dëmi shkaktohet në shumë raste dhe në mënyra të ndryshme me pasoja për jetën e njeriut dhe për pasurinë e tij. Hulumtimet që bëhen çdo vjetë në botë tregojnë se dëmet e shkaktuara kapin vlerën me miljarde dollar.

Dëmi i shkakuar duhet edhe të paguhet mirpo gjithënjë duke pasur parasysh kushtet e caktuara që dëmi të ekzistojë pra të jetë shkakuar me veprime konkrete të ndërmarura apo me mos veprim ose mos bërje, sepse pa ekzistimin e dëmit nuk mund të bisedohet dhe të kërkohet për asnjë lloj përgjegjësie dhe as për shpërblimin e tij.

1. Dëmi

Sipas ligjit për marrëdhëniet detyrimore të Maqedonisë – Dëmi është zvoglimi i pasurisë së dikuj (dëm real apo i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i munguar apo i humbur), si dhe shkakimi i ndonjë dhembje fizike apo psikike dhe friksimi i dikujt (dëmi jomaterial)³. Dëmi mund të shkaktohet nga shkaqet e ndryshme. Si shkaqe të shkakimit të dëmit mund të paraqiten: sjellja e njerëzve (personat fizik dhe juridik me veprimet aktive ose pasive); sendet (nga helmet, eksplozimi i gazrave, rrymat elektrike etj.); veprimet e rrezikshme (dëmi i shkakuar në xehërore, në trafik, në ndërtimtari, etj.); dhe ngjarjet (natyrore: rrufeja, stuhia, vërshimet, tërmetet, etj.).

² A.S.Alishani, E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme, Botimi i dytë, Prishtinë, 2002, faqe. 439, 440, 429, 430, 431.

³ Neni 142 i Ligjit për marrëdhënie të detyrimeve (LMD) i Maqedonisë.

Në definicionin dëm hasemi në dy kuptime: atë në kuptimin ekonomik dhe në kuptimin juridik. Në kuptimin ekonomik me dëm nënkuptojmë humbjen e pasurisë pamarparasish faktin si ka ardhur deri te kjo humbje, ndërsa në kuptimin juridik nënkuptojmë humbjen e ndonjë të mire apo interesi juridik të mbrojtur nga ligji në fuqi, dmth në të dy kuptimet bëhet fjalë për humbje.⁴ Dëmi paraqitet si një ndër kushtet më të rëndësishme të përgjegjësisë deliktore civile, përgjegjësia deliktore civile është kur i shkaktohet dëm tjetrit me veprimet kundërligjore dhe me fajin e dëmtuesit. Në kuptimin e ngushtë dëmi ka të bëjë me çdo cenim dhe çdo humbje të pasurisë, ndërsa sipas kuptimit të gjërë paraqet cenimin e pasurisë së ndonjë subjektit, cenimin e të drejtave dhe personalitetin e tij si dhe detyrimi i shpërblimit të dëmit që i është shkaktuar tjetrit.

1.1. Llojet e dëmit

Varësisht nga shkaktimi i dëmit bëhet edhe klasifikimi i llojit të dëmit, dëmi material dhe ai jomaterial. Ku njëri lloj i dëmit shkaktohet në pasurinë e personit të dëmtuar (dëmi material) dhe tjetri lloj në integritetin e tij (dëmi jomaterial).

1.1.1. Dëmi material

Me dëm material nënkuptojmë zvogëlimin e mjeteve shoqërore, gjëgjesisht pasurisë së dikuj si dhe pengimin e rritjes së tyre apo cenimin e vlerave material të ndonjë personi fizik apo juridik. Kjo ndodh kur dëmtohet apo i zhduket sendi dikuj, kur sendi nuk mund të përdoret, kur pengohet shfrytëzimi i sendit, si dhe në raste tjera eventuale kur shkaktohet humbje e drejtpërdrejtë e vlerës material të personit fizik apo juridik. Duke u bazuar në praktikën gjyqësore hasemi në shumë raste të dëmit material, ku si ndodhi e këtyre rasteve janë sjelljet e pa lejuara të dëmtuesit, i cili përmes veprimeve të tij pengon që dikush tjetër të kryej veprimtarinë e vet industrial dhe në këtë rast të dëmtuarit i shkaktohet dëm. Këto raste janë relevante edhe te shkaktimi i dëmit jomaterial. Te dëmi material si problem i veçant janë rastet që shkaktonin vdekjen e personit, shkaktimin e plagve trupore, dëmtimi i shëndetit të personat e caktuar.⁵ Kto raste janë të shumta dhe më së shpeshti ndodhin në vendet publike, në vendin e punës, në aksidentet e komunikacionit rrugor, ajror dhe atë ujor, ku në këto

⁴ A.Mahmuti, Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit material në Maqedoni (disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor”), Tiranë, mars 2013, faqe. 39.

⁵ A.S.Alishani, E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme, Botimi i dytë, Prishtinë, 2002, faqe. 461.

kumunikacione dëmet që shkaktohen janë shumë të mëdha dhe me pasoja të rënda. Format e dëmit material, mbi bazën e të cilave jepet kompensim janë: a) Mbjtja e humbur e anëtarëve të familjes, në rastet e vdekjes së bashkëfamiljarit b) Humbja e fitimit për shkak të paaftësisë së përhershme, të plotë ose të pjesëshme për punë të të lënduarit; c) Fitimi i munguar për shkak paaftësisë së përkohshme për punë; d) Shpenzimet e mjekimit dhe të rehabilitimit; e) Shpenzimet për kujdesin dhe ndihmën e huaj nga personi i tretë; f) Dëmtimi i sendeve që përdoren për nevoja personale, rrobat etj; g) Shpenzimet e varrimit dhe ngritjes së përmendores mbivarrore;⁶

Me analizimin e llojeve ekzistuese të dëmit material kuptohet se nuk ekzistojn lloje unike të dëmit material në të drejtën nacionale.

Në doktrinën juridike dhe në praktikën gjyqësore përmenden disa lloje të dëmit material ku dhe ne do ti numrojm me rrath sipas llojit të tyre.

Teoria juridike dhe praktika gjyqësore, vend të rëndësishëm i kanë krijuar këtyre llojeve të dëmit material: a) dëm i vërtet (*damnum emergens*), b) fitim i munguar (*lucrum cessans*), c) dëm abstrakt, d) dëm konkret, e) dëm i drejtpërdrejtë, f) dëm i tërthortë, g) dëm ekzistues, h) dëm i ardhshëm, i) dëm i paraparë, j) dëm i paparaparë e të tjerë. Të flasim një nga një për secilin lloj dëmi të lartëshënuar.⁷

Dëmi i vërtet (damnum emergens) – vjen në shprehje kur personit i është dëmtuar e drejta pasurore. Sa i përket vlersimit të dëmit të vërtet që ndodh në pasurin e të dëmtuarit, bëhet në mënyrë të thjesht duke bër dallimin midis pasuris së të dëmtuarit para shkakimit të dëmit dhe pasuris pasi të ket ndodhur shkaktimi i dëmit.

Sa i përket këtij dallimi negative do të vërehje se i dëmtuari është dobësuar apo varfëruar në aspektin pasuror. Kjo ndodhë kur paraqiten raste si dëmtimi i shtëpis, kur dëmtuesi e thyen dritaren derën e dikuj, kur personit i vidhet vetura etj. Për kët lloj të dëmi përdoren emërtime të ndryshme sikurse dëmi i vërtet, dëm i thjesh, dëm pozitiv, dëm i rëndom etj. Dy emërtimet e para më së shumti janë në përdorim në doktrinën, në rregullativë dhe në praktikën gjyqësore. Ky lloj dëmi na paraqitet si në rastin kur dëmi shkaktohet nga

⁶ Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), nenin 4, paragrafi 3 si dhe nenin 9 paragrafi 2 të Ligjit nr.05/L-045 për Sigurimet, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.38/24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 31 gusht 2016, miratoi si vijon: RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PER VLERSIMIN E DËMEVE JOMATERIALE NGA AUTOPËRGJEGJËSIA KREUI DISPOZITA TË PËRGJITHSHME, faqe. 9.

⁷A.Mahmuti, Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit material në Maqedoni (disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor”), Tiranë, mars, 2013, faqe. 40.

veprimi daliktor d.m.th pa ekzistuar marëdhënia juridike. Si dhe në situatë kur çënohet kontrata e plotëfuqishme.

Fitimi i munguar (lucrum cessans) – ky lloj i dëmit shkaktohet kur i dëmtuari pengohet që të rris pasurin e tij, d.m.th sikurse të mos ndodhte pengimi i subjektit do ta rriste pasurin në të ardhmen, psh., pengimi i ndërtimit të një objekti për të cilin i dëmtuari kishte për qëllim që të shfrytëzoj atë objekt me dhënije të qiras për një kohë të afërt, pra ky dëm nuk cenon vlerat aktuale pasurore, por rastet kur i dëmtuari pengohet në rritjen e vlerës së pasurisë së tij.

Nenin 173 i LMD të Republikës së Kosovës parashikon vlerësimin e lartësisë së fitimit të humbur ku merr në konsiderim fitimi që ka mundër të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjerave, e realizimi i të cilit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmer veprimin.⁸ Gjithashtu edhe ky lloj dëmi material mund të realizohet si në mardhëniet kontraktore po ashtu edhe në marëdhëniet jashtkontraktore.

Kolegjet e bashkuara të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë kanë bërë dallimin ndërmjet humbjes së pësuar nga pakësimi i pasurisë që njihet si dëm aktual dhe pengimit të rritjes së pasurisë si fitim i humbur apo i munguar. Në rastin e parë si objekt të dëmit kemi humbjen e një interesi pasuror aktual. Në rastin e dytë sa i përket fitimit të munguar kemi të bëjmë me pengimin apo pamudësin e përfitimit të interesit pasuror të ardhshëm, pra shaktimi i dëmit ndodhë në pasurinë që ende nuk i përket të dëmtuarit.⁹

Fitim të humbur si pengimi i rritjes së pasurisë kemi edhe tek marëdhënia e punës, psh., mes puntorit dhe punëdhënsit ku ky i fundit në mënyrë të paligjëshme largon puntorin nga puna dhe në këtë rast është bërë pengimi i pasurisë së puntorit që do të kishte në të ardhmen. Fitimi i humbur si pasojë e aksidenteve të trafikut që janë objekt i sigurimit të detyrueshëm nga auto përgjegjësia, duhet të provohet me dokumentacionin nga personi i lënduar dhe kompensimi do të bëhet kur të provohet se lëndimi ka pasojë që rezultojnë në menjanimin e aktivitetit punës të përhershëm ose të përkohëshëm. Në këtë rast gjatë vlerësimit të lartësisë së fitimit të humbur merret parasysh fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjerave, ku realizimi i të cilave është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmer veprimin.¹⁰

⁸ Ligji Nr.4/L-007, për marrëdhënie e detyrimeve të Republikës së Kosovës, neni 173, faqe. 54.

⁹A.Nuhiu, E drejta e sigurimeve në aksidentet automobilistike në Maqedoni (punim doktriture) Tiranë, 2013, faqe. 10

¹⁰ Bazuar në nenin 35, paragrafi 1. Nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209, për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), neni 4, paragrafi 3 si dhe neni 9 paragrafi 2 të Ligjit nr.05/L-045 për sigurimet, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.38/24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mledhjen e mbajtur me 31 gusht 2016, miratoi si vijon:

Dëmi konkret – gjithashtu edhe dëmi konkret është lloj i dëmit material që mund t'i shkaktohet të dëmtuarit. Ekzistimi i këtij dëmi është kur shkaktimi i dëmit është evident dhe sipas rregullave konkrete të cilatë egzistojn në momentin e shkakimit të dëmit. Lartësia e dëmit konkret bëhet në bazë të rrethanave konkrete që ekzistojn në një rast, pasi ai rast paraqet humbje të të dëmtuarit. Dëmi konkret vërtetohet dhe llogaritet sipas rregullave konkrete të cilat ekzistojn në rastin konkret të dëmit të shkakuar. Është shprehja në të holla, e caktuar në mbështetje të vlerës në treg të sendit të dëmtuar.

Konkretizimi dhe vlersimi i lartësis së dëmit konkret mund të bëhet duke i përdorur të gjitha mjetet e provës, siç janë: kqyrja në vendin e njarjes tek sendi i dëmtuar, dëshmitarët, eksperti, dokumentet publike apo private, parnimi nga vet shkakuesi i dëmit etj.¹¹

Dëmi abstrakt – ky lloj dëmi caktohet në mënyra abstrakte, pamarparasysh dëmin e vërtet të shkakuar, duke e caktuar në mënyrë paushalle ose me përgjindje, ku thuhet se ky dëm në esencë nuk është shkakuar, por është dëm i parapar për faktin e shkakimit të dëmit, psh: me rastin e thyerrjes së xhamit të veturës, vjedhjes, është e lehtë të përcaktohet vlera e dëmit, pasi në bazë të çmimoreve konkrete apo çmimit aktual të tregut përcaktohet lehtë lartësia e kompensimit që duhet të paguan dëmtuesi.¹² Përcaktimi i lartësis së këtij dëmit të shkakuar që më parë nga dëmtimi i caktuar zakonishtë është më i lartë dhe me i lehtë për tu përcaktuar, pasi e njejta dihet që paraprakisht dhe nuk mvaret nga vlera reale e dëmit të shkakuar.

Dëmi i drejtpërdrejtë – çdo veprim i paligjshëm nga ana e një personi qoftë fizik apo juridik do të shkaktoj dëm në ndonjë vlerë të personit tjetër të dëmtuar. Kështu që edhe te dëmi i drejtpërdrejtë do të ekzistoj kur do të dëmtohet ndonjë vlerë me veprim antijuridik ose kundërligjore në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me ndojë lëshim ligore, që sikur të ndërmirte nuk do të vinte deri te ekzistimi i dëmit. Dëmi i drejtpërdrejtë është dëm në të cilin është cenuar ndonjë vlerë juridike e të dëmtuarit, psh, në dëmtimin e shëndetit dëmi i drejtpërdrejtë përfëshin: shpenzimet e mjekimit, shërbimet e ndryshme lidhur me shërim, kurse nese dëmi u është shkakuar sendeve të të dëmtuarit, si dëm i drejtpërdrejtë konsiderohen shpenzimet lidhur me riparimin e sendit të dëmtuar. Nga dëmi i drejtpërdrejtë njëkohsisht paraqiten edhe veprimi i dëmshëm edhe efektet e dëmit.

RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PER VLERSIMIN E DËMEVE JOMATERIALE NGA AUTOPËRGJEGJËSIA Nenin 14, faqe. 10.

¹¹A.Mahmuti, Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit material në Maqedoni (disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor”), Tiranë, mars 2013, faqe. 42.

¹²Po aty, faqe. 42.

Dëmi i tërthortë – ky lloj dëmi është një dëm që vjen si pasojë jo e drejtpërdrejtë e veprimit të kundërligjshëm apo mos ndërmarrjes së veprimit me të ciliën dëmtohet pasuria e personit tjetër. P.sh., nga moskujdesja e mekanikut për servisimin e automjetit në mënyrë jo të duhur, mund të vjen deri te bllokimi apo shkaktimi i një dëmi më të madhë të automjetit pas një kohe të shkurtër.

Dëmi efektiv – është ai dëm material i cili ekziston apo është shkaktuar bashkë me pasojat e tij që në momentin e shkaktimit të dëmit. Në momentin e shkaktimit të këtij dëmi vërtetohet ekzistimi i dëmit, latësia e tij si dhe përgjegjësia e vet dëmtuesit. Në këtë rast edhe ndihma mundet të jetë evidente nga ana e ekspertit gjyqësor për vërtetimin e të gjitha fakteve rrethë këtij dëmi.

Dëmi i ardhshëm – është ai dëm i cili ende nuk është paraqitur por supozohet se në të ardhmen me siguri do të shkaktohet. Paraqitja e sigurt e pasojave është lidhur me veprimin e dëmshëm që ka shkaktuar dëmin momental të një të mire material apo jomateriale, ku sipas këtij lloji të dëmit bazohemi edhe në paraqitjen e dëmeve shtesë në të ardhmen. Edhe LMD bën fjalë për dëmin e ardhshëm në nenin 192, ku thotë: “Gjykata me kërkesë të të dëmtuarit do të gjykojë edhe shpërblimin e dëmit të ardhshëm jomaterial nëse sipas vazhdimit të rrethanave është e qartë se pasojat do të vazhdojnë edhe në të ardhmen”.¹³

Dëmi i parapar – gjithashtu është lloj i dëmit material, dëm të cilin dëmtuesi në momentin e marrjes apo lëshimit të veprimit të dëmshëm ka mundur të vërej se më vonë do të shaktojë dëm përmes aty veprimi apo lëshimit të veprimit. Sa i përket këtij dëmi kemi rastet të shpeshta në praktik si p.sh., kur një shitës në shitoren e tij mban mall me afate të skaduara dhe në momentin e shitjes së këtij malli do të shkaktohet dëm i parapar, pasi shitësi është dashur të dijë apo ka mundur ta parashikojë se përmes këtij veprimi apo mosveprimi ku në këtë rast nga mos veprimi i shitësit i cili është dashur të veprojë për ta larguar atë mall nga vendi i shitjes, por këtë gjë nuk e ka bërë dhe ka shkaktuar dëm të parapar.

Dëmi i paparapar – ky dëm ekziston kur dëmtuesi nuk ka mundur të parashohë se me ndërmarrjen e veprimeve të tij do të shaktojë dëm në momentin e caktuar. Ky moment rezulton më së shumti në rastet kur kemi marrëdhënie detyrimore mes paleve, shfaqja e këtij dëmi ndodh kur krijohet ndonjë rrethanë e paparashikuar në atë marrëdhënie detyrimore.

¹³A.Mahmuti, Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit material në Maqedoni (disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor”), Tiranë, mars 2013, faqe. 43.

1.1.2. Dëmi jomaterial

Dëmi jomaterial – ky dëm shkaktohet pavarësisht nga dëmi material por në shumicën e rasteve paraqiten bashkë me dëmin material p.sh., lëndimi trupor, shëmtimi etj.

Dëmi jopasuror i trajtuar nga Gjykata Themelore për të Drejtat e Njeriut, dëmin jopasuror e vleron si një ankthë, gjendej mendore e ngarkuar, stresi, paretia, hithërimi dhe shgënjimi, pasiguria, shqetësimi i pësuar nga palët gjatë çdo lloji procesi gjyqësor, apo për shkak të faktit të paligjshëm që përbën edhe shkeljet të konventës.¹⁴

Dëmi jomaterial ekziston kur të dëmtuarit i shkaktohet dhembje fizike, vuajtje psikike dhe frikë. Gjithashtu dëmi jomaterial cenon të mirat personale të të dëmtuarit, dinjitetin, autoritetin, prishjen e qetësis personale dhe familjare etj.

Vështrimi i përgjithshëm mbi formën dhe përmbajtjen e dëmit jomaterial është çdo lloj dëmi të pësuar nga cënimi i të drejtave dhe interesave jomateriale që bëjnë pjesë në vlerat e njeriut dhe që nuk janë subjekt vlersimi ekonomik. D.m.th dëmi jomaterial (jopasuror) nënkupton çdo lloj dëmi të pësuar nga cenimi i të drejtave dhe interesave jomateriale, që kanë të bëjnë me dhembje fizike invaliditetin jetësorë, shëmtimin dhe vuajtjet psikike të anëtarëve të familjes së ngushtë për personin e ndjer apo posaçërisht rëndë të lënduar. Përgjegjësia për dëmin jomaterial – personi që pëson një dëm të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur:

1. kur ka pësuar një dëm të shëndetit ose është cënuar në nderin e personalitetit të tij;
2. kur është fyer kujtimi i një të vdekuri dhe kërkohet nga bashkëshorti me të cilin ka bashkëjetuar deri në ditën e vdekjes ose nga të afërmit e tij deri në shakllën e dytë, përveç kur fyerja është kryer kur i vdekuri ka qenë gjallë dhe i është njohur e drejta e shpërblimit të dëmit për fyerjen e bërë;¹⁵
3. është cënuar e drejta e emrit;
4. është cënuar respektimi i jetës private;

Pra sipas këtyre rregullave, çdo kush ka të drejtë të kërkojë nga organet kompetente që të urdhërojnë ndërprerjen e veprimeve me të cilat veprime cënohet integriteti i personalitetit të njeriut, jeta personale e tij dhe ajo familjare.

Duke bërë analizimin e këtyre rregullave mund të vërehet pa dyshim se KC dhe LD jo vetëm që duhet t'i mbrojnë këto vlera të të drejtave të njeriut, por këto vlera janë të lidhura

¹⁴ Etleva Temo, “Dëmi jopasuror dhe shpërblimi i tij”, Biblioteka e Universitetit të EJL, faqe. 149.

¹⁵ Ligjet.info/ dispozitat të përgjithshme, neni 625 - përgjegjësia për dëmin jo pasuror.

edhe me të drejtat e njeriut që mbrohen në rregullat e unifikuara, çdo kushtetutë nacionale këto të drejta duhet me kujdes t'i mbrojë.¹⁶

Dëmi jomaterial gjithashtu ka edhe pjesët përbërse të tij duke përfshirë dëmin biologjik, moral, dhe dëmin ekzistencial. Dëmi biologjik përbën në thelb cenimin e së mirës së shëndetit të integritetit fizik ose psikik të njeriut, dhe që ka një ndikim negativ në aktivitetet jetësore të përditshme.

Dëmi moral është shfaqja e mbrendshme e turbullimit të gjendjes shpirtore të njeriut, dhimbjet e vuajtjet shpirtore individuale dhe familjare të të dëmtuarit.

Dëmi ekzistencial është cënimi i të drejtave të personit të njeriut duke dëmtuar në mënyrë të përhershme shprehjen e të dëmtuarit si njeri, ose të familjarve të tij në botën e jashtme, duke tronditur objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtarin e zakonshme të tij si në cilësinë e jetës, ashtu edhe në marrëdhëniet personale dhe familjare.¹⁷

Në praktikën gjyqësore dëmi jomaterial shpërblehet kur shkaktohet vuajtja psikike, dhimbja fizike dhe frika.

Dëmi jomaterial vjen si pasojë e veprës penale, e veprimit deliktore dhe si pasojë e cenimit të kontratës.

Individi që ka pësuar dëm jomaterial, përmes gjykatës i mundësohet shpërblimi në para që ndikon në zbutjen e tronditjeve subjektive që janë shkaktuar në personalitetin e viktimës. Ky shpërblim nuk paraqet një çmim për dhimbjet e përjetuar, por ka për qëllim që të dëmtuarit të mundësohet rivendosja e ekuilibrit psiko-fizik që ka ekzistuar para se të shkaktohet ky dëm.

2. Aftësia Deliktore

Aftësia deliktore është kushtë i përgjithshëm i përgjegjësisë deliktore. Paraqet aftësinë e një subjekti që të kuptoj veprimet e veta.

Aftësia deliktore – nënkupton që personi të përgjigjet me masën e vet pasurore për deliktet apo dëmet që i shkakton personit tjetër. Për dallim nga zotësia për të vepruar e cila fitohet nga moshën 18 vjeçare dhe zotësia juridike e cila fitohet me lindjen, zotësia apo aftësia deliktore fitohet në moshën 14 vjeçare, pra këto aftësi janë sa i përket personit fizik, ndërsa personi juridik të tre aftësitë e lartpërmenduarat i fiton në të njëjtë kohë që do të thotë në

¹⁶A.S.Alishani, E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme, Botimi i dytë, Prishtinë, 2002, faqe. 466.

¹⁷www.academia.edu

moment e regjistrimit kurë e fiton cilësinë e personit juridik.¹⁸ Aftësia deliktore është aftësi e një subjektit që t'i kuptoj veprimet e veta dhe për pasojat e atyre veprimeve të përgjigjet vet ai, për deliktin që ja ka shkaktuar tjetrit. Sa i përket asaj se personi a do të përgjigjet për shkaktimin e dëmit, ajo do të mvaret nga mosha dhe aftësia për të gjykuar, sipas dispozitave ligjore të Maqedonisë aftësia deliktore arrihet me fitimin e zotësis së veprimit që do të thotë me arritjen e moshës madhore.

Në çështjen lidhur me kategorizimin e personave sa i përket moshës lidhur me aftësin deliktore në dispozitat ligjore të Republikës së Maqedonisë ekzistoj disa kategori: personat gjer në moshën 7 vjeçare janë fëmij dhe nuk përgjigjen për dëmin e shkaktuar prej moshës 7 veçare deri në 14 vjeçare janë kategori e të miturve të rinjë dhe nuk përgjigjen për dëmin e shkaktuar përveç nëse vërtetohet se gjatë shkaktimit të dëmit ka qenë i aftë për gjykim, dhe personi që ka mbushur 14 vjet përgjigjet për dëmin e shkaktuar sipas rregullave të përgjithshme të përgjegjësis së dëmit.

Jo të gjithë personat me arritjen e moshës së caktuar e fitojn aftësin deliktore. Paaftësin deliktore e kanë personat që e kanë të kufizuar zotësin e veprimit apo ngecjes në zhvillimin mendor, nuk është i aftë për gjykim dhe nuk përgjigjet për dëmin që ja shkaktonte tjetrit. Personat me paaftësi deliktore sa her që do të shkaktajn dëm përgjegjësia e këtij dëmi me ligje do të bie mbi personat që e kanë për detyrë mbikqyrjen ndaj personave të paaftë qoft ai të jetë kujdestar apo organ tjetër institucional.

2.1. Aftësia deliktore e personave fizik

Aftësia deliktore për shkaktim dëmi nga personat fizik. – Aftësia deliktore e personit fizik paraqitet si kusht i përgjithshëm i përgjegjësisë jashtëkontraktore. E theksojmë në mënyrë të veçantë vetëm përgjegjësinë jashtëkontraktore, pasi te përgjegjësia kontraktore, aftësia e palëve përveç se paraprakisht nënkuptohet (nuk mund të jenë palë në kontratë personat me pa zotësi veprimi), dhe se të drejta dhe detyrimet lindin vetëm për subjektet e kontratës – inter partes, ku si subjekte, personat fizik mund të jenë vetëm të moshës madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar. Në të kundërtën, duhet të jenë të përfaqësuar nga persona me zotësi të plotë për të vepruar.¹⁹

¹⁸A. Aliu, E drejta civile, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2013, faqe. 233.

¹⁹A. Mahmuti, Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit material në Maqedoni (disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor”), Tiranë, mars 2013, faqe. 51.

2.2.2. Aftësia deliktore e personave juridik

Aftësia deliktore e personave juridikë – personat juridik ashtu sikurse personat fizik edhe këta kanë aftësin deliktore dhe të njejtin mund të kenë rolin e palës dëmtuese, ku në këtë raste aftësia deliktore është kushtë i përgjithshëm për lindjen e përgjegjesis. Personat juridik përgjigjen për dëmin kur e shkaktojnë puntorët e tij apo organet e tyre si përfaqësues të personit juridik duke kryer punën e tyre për të cilën janë të ngarkuar këta subjekte dhe në këto raste përgjegjësia bie mbi masën pasurore të personit juridik e jo në masën pasurore të puntorit apo individit si anëtar i personit juridik në këtë rast përgjegjësia e personit juridik do të llogaritet sipas shkallës së fajit të organit të tij.²⁰ Personi juridik pasi përgjigjet për dëmin që e shkaktojnë përfaqësuesit e tij, në bazë ligjore ka të drejt të kërkoj shpërblimin e dëmit të paguar nga antari i tij nëse vërtetohet se ka qenë fajtor për dëmin e shkaktuar.

Sipas KCSH-së në nenin 32, parashihet se “personi juridik është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga organet e tij gjatë përmbushjes së detyrave të tyre”, paragrafi 2 “personi juridik përgjigjet për detyrimet e tij mbrenda kufive të pasurisë së tij”, dhe paragrafi 3 “personi që ka vepruar në cilësinë e organit të personit juridik kanë përgjegjësi vetjake për shpërblimin e dëmeve që janë shkaktuar për fajin e tyre”²¹

Aftësia deliktore e personit juridik fitohet me regjistrimin e tij në regjistrin qendror për regjistrim të personave juridik.

3. Lidhja kauzale

Lidhja kauzale është një kategori e shumë shkencave shoqërore si dhe natyrore kurse sa i përket shkencës juridik lidhja kauzale për veç të drejtës detyrimore ajo është kategori edhe e të drejtës penale. Megjithatë lidhja kauzale studiohet në sferën e përgjegjesis deliktore, me studimin e saj merren shkencat natyrore dhe shoqërore, e veçmas filozofia.²²

Lidhja kauzale vjen si raport i ndërsjellt mes veprimit të kundërligjshëm, dhe dëmit, ku veprimi paraqitet si shkak, kurse dëmi si pasojë e saj.

²⁰ A. Mahmuti, Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit material në Maqedoni (disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor”), Tiranë, mars 2013, faqe. 53.

²¹ A. Aliu, E drejta civile, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2013, faqe. 233.

²² O. Kadriu, Shkaktimi i dëmit dhe përgjegjësia civile juridike vështrim i veçant mbi shkaktimin e dëmit nga ndërprerja e punës dhe e mardhënies së punës pa bazë juridike Shkup, 2003, faqe. 48.

Kur është pyetja për lidhjen shkakësore si kategori e të drejtës detyrimore LMD por as edhe ndonjë ligjë tjetër, nuk mund të japin përgjigje përshkak numrit të madh të rasteve të cilat nuk mund të parashikohen ose më parë të rregullohen me ligj. Për këtë arsye përgjigjësia e kësaj pyetjeje i është lënë shkencës dhe praktikës të cilat në çdo rast konkret duhet të japin përgjigje për shkakun që ka shkatuar dëmin si pasojë e saj. Shkenca civile juridike përpiket që këtë nocion ta ndriçojë në bazë të premisave të caktuar dhe mbi këtë bazë të japë përgjigje a ekziston në një mardhënie konkrete civile juridike lidhja kauzale në mes veprimit dhe pasojës ose nuk ekziston kjo lidhje.²³ Lidhja kauzale është kusht i përgjithshëm i përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, qoftë përgjegjësia për veprimet personale, përgjegjësia për të tjerët dhe përgjegjësia për sendet e rezikshme apo për veprimtarin e rezikshme.

Kur flasmi për dëmet që janë shkaktuar nga sendet e rezikshme apo veprimtaria e rezikshme, përfëshi këtu të gjitha dëmet e shkaktuara, është me rëndësi të ceket se shkenca juridike dhe praktika e kanë pranuar prezumimin se ato dëme rezultojnë pikërisht nga ato sende apo nga ajo veprimtari²⁴. Lidhja kauzale paraqet rrethana të komplikuar përshkak se në praktikë mund të ndodh që një shkak i vetëm të shkaktoj disa pasoja apo disa shkaqe të shkaktojnë një pasojë të vetme. Lidhja kauzale ekziston, p.sh., kur pronari i lokalit afarist para lokalit të vet nuk e largon borën, akullin dhe kalimtarët e rastit duke kaluar lëndohen.²⁵ Lidhja kauzale jo gjithmonë mund të vërtetohet me mënyrë të lehtë dhe të qartë, ndërsa në disa raste mund të realizohet pa ndonjë mund të madhë, p.sh., kur dikush gris rrobat e dikuj, në këtë rast nuk ka vështirësi apo fare nuk paraqet problem për vërtetimin e ekzistimit të këtij kushti sepse në këtë rast ekziston lidhja kauzale ndërmjet veprimit të pa lejuar dhe pasojës së shkaktuar. Ndonjëherë ekzistojnë raste ku lidhja kauzale është vështirë të vërtetohet, siç është rasti për lëndimet trupore, për dëmet e shkaktuara në trafik etj. Në këto raste kërkohet ndihmë nga ekspert gjyqësorë, sepse në këtë mënyrë gjykatësi më lehtë do të vërtetojë ekzistimin e lidhjes kauzale. Lidhja shkakësore si kategori e të drejtës detyrimore mund të jetë e drejtpërdrejtë dhe e tërthor. E drejtpërdrejtë kur veprimi i dëmshëm ka shkaktuar dëmin i cili është pasojë e tij e drejtpërdrejtë. Lidhja shkakësore e tërthorë është atëherë kur veprimi i dëmshëm ka shkaktuar dëmin i cili është pasojë e tërthorë e tij.

KCSH neni 609 paragrafi 1. Thotë “Dëmi duhet të jetë rrjetim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit apo mos veprimit të personit” kurse paragrafi tjetër thotë

²³ O.Kadriu, Shkaktimi i dëmit dhe përgjegjësia civile juridike vështrim i veçantë mbi shkaktimin e dëmit nga ndërprerja e punës dhe e mardhënies së punës pa bazë juridike Shkup, 2003, faqe.48

²⁴ A.Nuhiu, E drejta e sigurimeve në aksidentet automobilistike në Maqedoni (punim doktore), Tiranë, 2013, faqe. 96.

²⁵ N.Dauti, E drejta e detyrimeve (pjesa e përgjithshme dhe e veçantë), Prishtinë, 2001, faqe. 160.

“Mospengimi i një njarjeje nga personi që ka detyrim ligjor për ta menjanuar, e ngarkon atë me përgjegjësin për dëmin e shaktuar”.²⁶

Si kushtë i përgjithshëm për ekzistimin e dëmit të shkaktuar, lidhja shkakësore duhet të jet e pandërprerë. Ndërprerja e saj pamarparasysht shkakun që ka ardhur çon deri te ajo lidhje që të mos ekzistojë pas asaj ndërprerje, pra dëmtuesi nuk do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar pas ndërprerjes së lidhjes shkakësore.

Teoritë juridike mbi lidhjen kauzale janë: a) **teoria e kushtit**, b) **teoria e kauzalitetit të drejtpërdrejtë** dhe c) **teoria e kauzalitetit adekuat**.

Teoria e kushtit – sipas kësaj teorie veprimi i dëmshëm mund të paraqes shkakun e dëmit. Si veprim të dëmshëm të palës duhet marë parasyshtë atë veprim për të cilin nuk do të mund të shfaqej pasoja e dëmshme.

Në kuadër të kësaj teorie bëhet fjalë edhe për kushtin fillestar. Sipas kushtit fillestar, veprimi i dëmshëm që në momentet e para të ndërmarrjes së tij mund të shkaktoj pasoja të caktuara, si dhe deri në përfundimin e tij mund të shkaktoj pasoja tjera. Sipas kësaj teorie në qoftë së një subjekt e pengonë dikë që të udhëtoj në kohë të caktuar, dhe ati i duhet të udhëtoj më vona shkakun i atij pengimi ku në atë udhëtim të më vonshëm pëson fatkeqësi në komunikacion e cila fatkeqësi do të shprehet me dëm të shkaktuar. Siaps kësaj teorie, këtu do të përgjigjet ai që e ka penguar të dëmtuarin dhe pikiërisht ai është subjekti përgjegjës për shpërblimin e dëmit. Kjo merr parasysht rrethanat e para (kushtin fillestar) e cila në mënyrë zingjirore të pandërprer ka ndikuar në rrethanat tjera që të shkaktohet dëmi. Kësaj teorie i bëhet vëretje të caktuar pasi e zgjeronë përgjegjësin civile përtej suazave të përgjegjësive për dëmin e shkaktuar,²⁷ dhe është e paloqikshme arsyetimi që shkaktarë të meret personi që e ka penguar subjektin në udhëtimin fillestar që të përgjigjet edhe për njarjet tjera zingjirore të pandërprera.

Teoria e kauzalitetit të drejtpërdrejtë – sipas kësaj teorie për të ekzistuar përgjegjësia civile, duhet që pasoja të jet e shkaktuar nga veprimi i drejtpërdrejtë i personit, pra sipas kësaj teorie veprimet e tjera tërthore nuk kanë rëndësi juridike por vetëm ato veprime të drejtpërdrejta që nënkupton se nëse një subjekt i ka shkaktuar dëm një subjektit tjetër atëherë subjekti që ka shkaktuar dëm do të përgjigjet vetëm për dëmin që shkaktohet nga shkelja e menjëhershme dhe e drejtpërdrejtë, p.sh., nese dikush pengohet që të udhëtoj me tren dhe ai udhëtimin e bën pas një kohe dhe i shkaktohet dëm në këtë udhëtim atëherë për

²⁶ A.Mahmuti, Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit material në Maqedoni (disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor”), Tiranë, mars 2013, faqe. 48.

²⁷ A.S.Alishani, E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme, Botimi i dytë, Prishtinë, 2002, faqe. 468.

dëmin që e pëson udhëtari në këtë fatëkeqësi do të përgjigjet kompania hekurudhore e jo subjekti që ka penguar udhtarin në trenin e parë.

Kësaj teorie i bëhet vërejtje sepse merr parasysh vetëm dëmin integral por jo edhe rrethanat e tërthorta që mundë të ndikojnë në shaktimin e pasojës së dëmshme si dhe fitimi i munguar. Kështu p.sh., nëse një tregëtar shet një kafshë të infektuar, me çrastë blersit i infektohen edhe kafështë e tjera dhe i ngordhin në këtë rast do të fitoj të drejtën e shpërblimit për kafësht e ngordhura por jo dhe dëmin që rezulton për të fituar sikur të mos kishin ngordhur kafshët tjera (fitimi i munguar).²⁸

Teoria e kauzalitetit adekuat – përfaqësuasit e kësaj teorie konsiderojn se kauzaliteti adekuat merr për bazë raportin në mes veprimit të dëmshëm, i cili duhet të jetë në proporcion me dëmin e shkaktuar dhe përcaktohet se sa ajo pasojë është adekuate me veprimin e dëmshëm. Kjo teori, për dallim nga dy të parat, merr parasysh të gjitha shkaqet që mund të kenë ndikim në shkaktimin e dëmit.²⁹ Kështu do të jet kur dikush e lëndon tjetrin dhe sipas rregullave ai është i obliguar t'i shpërblej jo vetëm shpenzimet e shërimit, por edhe fitimin e munguar për kohën deri sa i dëmtuari nuk ka mundur të kryej aktivitetin personal. Kjo teori më së shumti gjen zbatim në praktikën gjyqësorë të Gjermanisë, Zvicrës, Austrisë, Francës etj. Sipas teoris Gjermane, lidhja kauzale është adekuate “nese veprimi i dëmshëm në përgjithësi është adekuat që ta shkaktoj pasojën e dëmit, por jo edhe në rastë kur pasoja mundë të shkaktohet, si rezultat i rrethanave specifike krejtësishtë të pa parashikuara për të cilat sipas rrjedhës së zakonshme të punve nuk mbahet llogari”.

4. Veprimi i kundërligjshëm

Kuptimi i veprimit të kundërligjshëm. - Veprimi i kundërligjshëm paraqet kushtin e përgjithshëm për lindjen e përgjegjësis juridike civile. Veprimi i kundërligjshëm është ai veprim apo mosveprim i njeriut me anë të të cilit cenohet ndonjë normë juridike, ose ndonjë normë e moralit njerzor.³⁰ Me veprim të kundërligjshëm apo mosveprim mundë të cenohen edhe interesat e karakterit material edhe ato interesa të karakterit personal dhe kjo mundë të ndodh si te personat fizik ashtu edhe te personat juridik. Kundërligjshmëria rrjeth nga relacioni

²⁸ A.Mahmuti, Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit material në Maqedoni (disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor”), Tiranë, mars 2013, faqe. 49.

²⁹ A.Mahmuti, Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit material në Maqedoni (disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor”), Tiranë, mars 2013, faqe. 49.

³⁰ N.Dauti E drejta e detyrimeve (pjesa e përgjithshme dhe e veçant), Prishtinë, 2001, faqe. 161.

midis veprimit të njeriut dhe rregullimit juridik: vepër e kundërligjshme është ajo vepër që është në kundërshtim me normat e rendit juridik.³¹ Pra veprimi i personit që është në kundërshtim me të drejtën objektive, që ndryshe thuhet që është veprim i ndaluar pasi shkelen dispozitat ligjore me të cilatë ndalohet apo urdhërohet një veprim i tillë quhet veprim i kundërligjshëm dhe për dëmin e shkaktuar nga ky veprim parashikohet sanksion i zhdëmtimit të palës së dëmtuar. Caktimi i kundërligjshmëris është i rëndësishëm sepse e kompletan anën objektive të veprimit kundërligjorë, ndërsa ana subjektive-fajësia, do të caktohet vetëm pasi të konstatohet se vepra është e kundërligjshme. Vepra është e kundërligjshme kur është realizuar figura ligjore dhe në rasti konkret, nuk vepron ndonjë normë për përjashtimin e kundërligjshmëris.

Disa autorë i përfshinë në të njëjtin kusht edhe fajin edhe veprimin kundërligjor, duke e llogaritur fajin si pjesë përbërëse të kundërligjshmëris. Sipas këtyre juristëve, saherë që kryen një veprim të kundërligjshëm ai konsiderohet me faj. Disa autorë të tjerë mendojnë se duhet të ndahet faji nga kundërligjshmëria si kushte të posaçme për lindjen e përgjegjësisë deliktore, për faktin se në praktikë mund të ndodhë që personi të ketë kryer një veprim antijuridik, por nuk do të thotë që domosdoshmërisht të jetë me faj. Paraqiten situata kur vozitësi vozitë me shpejtësi të pa lejuar por nuk shkakton lëndime trupore të kalimtarët e rastit, me veprimin e tij edhe pse ka cilësinë e veprimit të kundërligjshëm nuk cenohet asnjë e drejtë e huaj subjektive dhe këtu nuk krijohet përgjegjësi juridike deliktore civile, por kundërvajtje në trafik.³²

Lidhur me nocionin e veprimit të kundërligjshëm në doktrinën juridike ekzistojnë tre teori: a) **teoria objektive**, b) **teoria subjektive** dhe c) **teoria objektive – subjektive**.

Sipas **teoris objektive**, veprimi i kundërligjshëm është ai veprim, i cili është në kundërshtim me normat juridike dhe cenohet interesi i përgjithshëm i shoqëris.

Sipas **teoris subjektive**, veprimi i kundërligjshëm është ai veprim, i cili cenon interesin individual të subjektit të dëmtuar. Sipas kësaj teorie faji paraqitet si pjesë përbërëse e veprimit të kundërligjshëm.

Sipas **teoris objektive – subjektive** kemi atëherë kur cenohet interesi individual, ashtu edhe kur cenohet interesi i përgjithshëm shoqëror.

³¹ V.Kambovski, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Botues SHB “Furkan ISM”, Shkup, 2006, faqe. 201.

³² N.Dauti E drejta e detyrimeve (pjesa e përgjithshme dhe e veçant), Prishtinë, 2001, faqe. 162.

4.1. Përrjashtimi i veprimet të kundërligjshëm.

Ekzistojnë disa rrethana të cilat e përrjashtojn kundërligjshëmërin e veprimet. – si rrethana të përrjashtimit të kundërligjshëmërisë së veprimet, sipas doktrinës juridike dhe legjislacionit të Maqedonisë, përrmendën: *mbrojtja e nevojshme, vetëndihma e lejuar, pëlqimi i të dëmtuarit përr t’iu shkaktuar dëm, kryerja e të drejtës së vet, kryerja e detyrës zyrtare dhe nevoja ekstreme.*

Mbrojtja e nevojshme – që të konsiderohet “e nevojshme”, mbrojtja duhet të plotësojë disa kushte ashtu si edhe sulmi. Kështu ky i fundit duhet të jetë i padrejtë, i vërtetë dhe i çastit. Një sulm do konsiderohet i padrejtë, kur ai synon të cenojë të drejtat dhe interesat e ligjshme të një personi dhe vetë sulmi vjen në kundërshtim me ligjin. Gjithashtu sulmi duhet të jetë i vërtetë, pra duhet të ekzistojë objektivisht dhe jo të jetë fryt i imagjinatës së mbrojtësit.³³

Edhe neni 9 i Kodit Penal të Maqedonisë, parasheh se: “Nuk konsiderohet vepër penal ajo vepër e cila është kryer në mbrojtje të nevojshme”.

Mbrojtje të nevojshme kemi atëherë kur personi shmang nga vetja apo dikush tjetër sulmin e njëkohshëm dhe të kundërligjshëm, drejtuar ndaj të mirave material apo personale të personit. Çdo her kur personi është sjell në mbrojtje të nevojshme dhe pasojat e dalura nga dëmi i shkaktuar të asaj mbrojtje, janë barrë e atij personi me fajin e të cilit është shkaktuar mbrojtje e nevojshme. Në këtë rastë është me rëndësi që vlera që mbrohet duhet të jetë më e lartë se dëmi që është shkaktuar. Çdo tejkallim i mbrojtjes së nevojshme detyron që shpërblimi i dëmit të bëhet nga personi që është sjell në mbrojtje të nevojshme, pra do të përgjigjet i mbrojturi. Që të ekzistojë mbrojtja e nevojshme duhet të plotësohen disa kushte.

1. Kushti i parë është: **sulmi që ka shkaktuar kundërsulmin duhet të jetë në kundërshtim me normat juridike dhe si i tillë të jetë i kundërligjshëm**, pasi po të mos ishte kështu atëherë kundërsulmi duhet të ishte i kundërligjshëm dhe do të duhet të përgjigjej personi që vepron në mbrojtje të nevojshme
2. Kushti i dytë është: **sulmi dhe kundërsulmi duhet të shkaktohen njëkohsisht**. Kjo do të thotë se të dyja veprimet duhet të shkaktohen në një interval të caktuar kohor ose njëri pas tjetrit. Po që se kalon një interval kohe nga sulmi deri te

33 A.Muskaj, Përgjegjësia civile nga shkaktimi i dëmit jopasuror, kandidat për gardën shkencore “Doktor i Shkencave, Tiranë, 2013, faqe. 33.

kundërsulmi, atëherë nuk bëhet fjalë për mbrojtje të nevojshme, por mund të bëhet fjalë për hakmarrje.

3. Kushti i tretë është që: **të ekziston reciprociteti ndërmjet sulmit dhe kundërsulmit.** Kjo nënkupton që palët duhet të veprojnë me mjete të përafërta me njëri tjetrin. (p.sh., nese njëra pale e godet me një mjet të butë, pala tjetër nuk duhet se ta godet me ndonjë mjet të fortë apo armë, pasi këtu nuk ka reciprocitet të veprimeve).³⁴

Dëmi i shkaktuar nga vetëndihma e lejuar – çdoher kur mbrojtja e të drejtave subjektive kryhet me forcën vetanake pa ndihmën e organeve të pushtetit publik quhet vetëndihmë. Vetëndihma ekziston kurë është e nevojshme që të menjanohet cenimi i të drejtës të cilës drejtpërdrejtë i kanoset rreziku; dhe kur mënyra e menjanimit të cenimit të së drejtës i përgjigjet rrethanave në të cilat është krijuar rreziku. Kjo do të ndodhë kur me marrjen e kundërligjshme të sendit të qiras nga qiramarsi i kanoset rreziku që ai të mos mund t'i ushtroj të drejtat e tij nga kontrata për qiranë.

Vetëndihma e lejuar – vetëndihma është mbrojtje ose realizimi i të drejtave subjektive me forcën vetanake pa ndihmën e organeve të pushtetit publik. Për të ekzistuar vetëndihma e lejuar duhet të plotësohen këto kushte: 1. Të ekzistojë kërkesa e personit të cilit i cenohet një e drejtë subjektive; 2. Rreziku i drejtpërdrejtë të jetë evident, saqë e bën të pamundur që pala e dëmtuar të pret reagimin e organeve shtetërore; 3. Masa e sigurimit të kërkesës të mos ketë mundësi që të realizohet nëpërmjet organit kompetent apo do realizohet me vonesë; 4. Veprimi i vetëndihmës të ndërmerret nga kreditori i cili i drejtohet detorit të vet; 5. Vetëndihma të jetë e lejuar dhe të ndërmerret nga personi i autorizuar; 6. Mënyra e ndalimit të cenimit kërkohet që të jetë në përputhje me rrethanat nga të cilat ka gjeneruar rreziku.³⁵

Dëmi i shkaktuar me pëlqimin e të dëmtuarit – nuk ka veprim të kundërligjshëm në rastet kur dëmi shkaktohet me pëlqimin e të dëmtuarit.

Subjekti i cili në dëm të vetë i lejon tjetrit shkaktimin e ndonjë veprimi, nuk mundë të kërkoj nga ai shpërblimin e dëmit të shkaktuar me atë veprim.

Sipas Ulpiani “Quia nulla est iniuria, que in volentium fiat” që do të thotë se nuk ka padrejtësi kundër atij që e pranon shkaktimin e dëmit. Pëlqimin duhet ta japë personi i aftë për punë dhe para se të ndërmerret veprimi i dëmshëm, por pëlqimi nuk duhet të jetë në

³⁴ A.Mahmuti, Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit material në Maqedoni (disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor”), Tiranë, mars 2013, faqe. 56,57.

³⁵ A.Mahmuti, Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit material në Maqedoni (disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor”), Tiranë, mars 2013, faqe. 57,58.

kundërshtim me normat imperative dhe të moralit shoqërorë. Vet pëlqimi i palës së dëmtuar i eliminon kushtet e përgjithshme për lindjen e përgjegjësis, atë të kundërligjshmëris dhe të fajit të dëmtuesit. Si raste të pranimit të të dëmtuarit më së shpeshti paraqiten ndërhyrjet specifike mjeksore ku pacienti paraprakisht jep pëlqimin dhe pajtohet me shkaktimin e pasojave eventuale nga ndërhyrja e mjekut. Kjo ndodh kur dikush me pëlqimin e tij pranon që ti hiqet ndonjë organ nga trupi i tij, për ta transplantuar te personi i afërm i familjes që gjindet në rrezik për jetë. Në këtë rast edhe pse personit i shkaktohet dëm nga mjeku, ai nuk ka të drejtë të kërkoj zhdëmtimin e pasojave përshkak së dëmi ka ardhur me pëlqimin e palës së dëmtuar, por gjithnjë duke pasur parasysh që shkaktimi i dëmit të ndërmar nga mjeku në këtë rast, nuk duhet ti kaloj kufijt e marveshjes së parapar nga pala në lidhje me shkaktimin e dëmit.

Si raste të përjashtimi të veprimit të kundërligjshëm duhet cekur edhe rastet e pëlqimit të të dëmtuarve në sportet luftarake si psh, në boks në karate xhudo etj, pra sa her që të ndodh që ndonjëra nga palët të lëndohet ajo nuk ka të drejt për shpërblim të dëmit, nëse pala tjetër ka vepruar në kuadër të rregullave të lojës.³⁶

Dëmi i shkaktuar duke kryer të drejtën e vet – nuk do të konsiderohet veprim i kundërligjshëm nëse një subjekt i shkakton dëm tjetrit duke kryer të drejtat e veta në kuadër të autorizimeve dhe suazave të ligji.³⁷ Që nga e drejta romake ka qenë e njohur rregulla që “kush e realizon të drejtën e vet, askujt nuk i bën padrejtësi” – Qui sou iure utitur, nemini facit iniuriam. Kjo nënkupton se personi duke vepruar mbrenda kufijve të ligjit realizon të drejtë e vet, por si pasoj e këtij veprimi i shkatohet dëm palës tjetër, nuk do të jetë përgjegjës për shpërblimin e dëmit nga fakti se veprimi i tij nuk cenon dispozitata ligjore dhe nuk prek kufijtë e ligjit.

Dëmi i shkaktuar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare – kemi raste të shumta kur personat zyrtar gjat kryerjes së detyrës zyrtare të shkaktojnë dëm, ku për shkaktuesin e dëmit nuk do të ketë përgjegjësi për dëmin e shkaktuar pasi veprimi i tyre bëhet në kuadër të ligjit dhe autorizimit zyrtar. Rastet të tilla kemi p.sh., kur rrënohet objekti i palës që ka bërë ndërtimin e objektit pa lejen e organit kompetent, kur policia gjatë shpërndarjes së turmës të protestuesve lëndon ndonjerin person ku në këtë rast edhe pse kemi shkaktim të dëmit, dëmtuesi nuk përgjigjet për dëmin e till për shkak se ka qenë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, gjithnjë duke pasur parasysh që veprimi mos ti kaloj kufijtë e autorizimeve të tij.

³⁶ N.Dauti, E drejta e detyrimeve (pjesa e përgjithshme dhe e veçant), Prishtinë, 2001, faqe. 165.

³⁷ Po aty, faqe. 163.

Dëmi i shkaktuar në nevojë ekstreme – nevojë ekstreme është gjendja që ekziston kur dikush i shkakton dëm vetvetes ose tjetrit, duke e menjanuar rrezikun që i kanoset drejtpërdrejtë. Nevoja ekstreme ekziston për mbrojtjen e interesave më të larta me veprimet e lejueshme, ku flijohet interesi më i vogël për të mbrojtur interesin më të lartë.³⁸

Veprimet me të cilat mund t'i shkatohet dëm tjetrit, parimisht janë të kundërligjshme. Mirpo këto rregulla nuk mund të jen absolute nga se kemi përjashtime në rastet e shkaktimit të dëmit gjatë ushtrimit të veprimtaris me interes të përgjithshëm dhe në bazë të lejes së lëshuar nga organi shtetëror kompetet, në kushtet e parashikuara me ligjë, në këtë rast kemi edhe nevojën ekstreme. Rastet e nevojës ekstreme janë të shpeshta që ndodhin në jetën e përditshme. Këto raste janë kur i shkaktohet dëm dikju duke evituar rrezikun i cili është i drejtpërdrejtë dhe është i njëkohshëm. Gjatë shkaktimit të dëmit nga gjendja e nevojës eksterme, i dëmtuari mundet të kërkojë shpërblimin e dëmit nga personi që është fajtor për shkaktimin e rrezikut për dëmin ose nga personi nga i cili është evituar dëmi. Por nga evituesi i dëmit nuk mund të kërkohe më tepër sesa dobia që ka personi të ket pasur. Kodi civil ka parashikuar se: personi që ka shkaktuar dëmin, duke qenë i shtrënguar nga nevoja për të shpëtuar veten ose të tjerët nga rreziku i atëçastëm i një dëmi të rënd, rrezik i cili nuk ka qen shkaktar dhe as që nuk mund të menjanohej prej tij, detyrohet të shpërblej dëmin.³⁹ Ky rregull ka edhe përjashtimin e vet sipas të cilit ekziston mundësia e shkarkimit apo kufizimit të përgjegjësis dhe kjo është lën në çmimin e gjykatës, pasi gjykata të ket vlersuar rrethanat e posaçme të çështjes.

Nisur nga pyetja përse ligjislatori nuk e ka përjashtuar autorin përgjithsisht nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar pasi çdo njeri do të kishte vepruar në këtë mënyrë? Përjashtimi nga përgjegjësia civile do të cenonte interesat e të dëmtuarit pa të drejtë, pasi ai nuk ka asnjë lidhje me faktin që ka se jll dëmin.

Nga ana tjetër nuk do të ishte e drejtë nese dikush do të vepronte për të mbrojtur një person tjetër nga një rrezik i çastit dhe të detyrohej më pas të dëmshpërblente ndonjë dëm të mundëshëm, që mund t'i ishte shkaktuar një të treti.

Që të konsiderohet një veprim i palës si veprimi i nevojës ekstreme, ai duhet të përmbaj disa karakteristika:

– *veprimi për shmangëjen nga rreziki duhet të ndodh në të njëjtën kohë, kur paraqitet edhe shkaktimi i dëmit;*

³⁸ A.S.Alishani, E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme, Botimi i dytë, Prishtinë, 2002, faqe. 485.

³⁹ A.Muskaj, Përgjegjësia civile nga shkaktimi i dëmit jopasuror, kandidat për gardën shkencore “Doktor” i Shkencave, Tiranë, 2013, faqe. 33.

- të mos kishte mënyrë tjetër për të eliminuar atë rrezik në atë kohë;
- vlera e të mirave material apo personale të shpëtuarra të jenë më të mëdha se dëmi që do mund të shkaktohej nga veprimi i nevojës.⁴⁰

Që të konsiderohej veprim legal nevoja ekstreme duhet që rreziku të ket qen real dhe vlera pasurore që mbrohet të jet më e madhe se sa ajo që sakrifikohet.

5.Faji

Faji është kushtë i përgjegjësis deliktore civile e në veçanti i përgjegjësis subjektive. Faji është kategoria subjektive. Me anë të fajit vërtetohet marëdhënia e shkaktuesit të dëmit ndaj veprimit të kundërligjshëm dhe ndajë dëmit si pasoj e tij.⁴¹

Që nga lindja e përgjegjësisë subjektive në periodën klasike romake dhe deri në ditën e sotme doktrina juridike është munduar që të jep një kuptim sa më gjithë përfshirës për çështjen e fajit. Përkundër kësaj, ende nuk ka një kuptim të vetëm për fajin, si kusht i përgjegjësisë subjektive për dëmin e shkaktuar. Duke analizuar rregullativën e të drejtave nacionale në LD dhe në KC mund të vërehej pa ndonjë mund se ky kushtë nuk përkufizohet e as që përcaktohet në ndonjë mënyrë në këtë lëmë. Kjo ndodh kështu, pasi, sikurse ligjvënësit ashtu edhe shkencëtarët kanë drojë, se mos ngushtohet fusha e zbatimit të tij dhe situata të caktuara të mbeten të përjashtuara.⁴² Faji është kushtë i përgjegjësis subjektive për dëmin e shkaktuar. Por ai nuk është kusht i përgjegjësisë të përgjegjësia objektive. Andaj duke marë parasysh këtë edhe ceket në doktrinë se faji është kushtë i veçantë i përgjegjësis për dëmin e shkaktuar. Në pikpamje të aplikimit të fajit si kushtë i veçant vetëm duhet të theksohet se faji aplikohet plotësisht te përgjegjësia subjektive; përgjegjësia për veprimet personale; te përgjegjësia për të tjetrin (personin e dytë) dhe veçmas te përgjegjësia kontraktore.⁴³

Nga ky konstatim rrjeth se rregullat e fajit kanë një fushë të gjërë të zbatimit, si në rastë kur me të shërbehet personi fiziki, personi juridik ose organi i shtetit. Ekzistimi i fajit është i nevojshëm si atëherë kur dëmtuesi është personi fizik ashtu edhe atëherë kur dëmtuesi është personi juridik.

⁴⁰ A.Mahmuti, Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit material në Maqedoni (disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor”), Tiranë, mars 2013, faqe. 61.

⁴¹ N.Dauti, E drejta e detyrimeve, (pjesa e përgjithshme dhe e veçant), Prishtinë, 2001, faqe. 165.

⁴² A.Mahmuti, Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit material në Maqedoni (disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor”), Tiranë, mars 2013, faqe. 77.

⁴³ O.Kadriu, Shkaktimi i dëmit dhe përgjegjësia civile juridike vështirë i veçant mbi shkaktimin e dëmit nga ndërprerja e punës dhe e mardhënies së punës pa bazë juridike, Shkup, 2003, faqe. 57.

Mendimet rreth kuptimit të fajit – analizat tregojnë se ekzistojnë disa mendime ose teori rreth kuptimit të fajit që më tepër vijnë në shprehje në doktrinën juridike dhe në praktikën gjyqësore. Sipas një mendimi për caktimin e fajit duhet të kyhet parasyshë aftësia e gjykimit, aftësia intelektuale e dëmtuesit në ndërmarrjen e veprimit. Sipas rezonimit të tyre faji është i njejtë si në të drejtën civile ashtu edhe në të drejtën penale. Ky rezonim nuk përkrahet në të drejtën bashkëkohore, sepse sanksioni në të drejtën penale është me karakter personal kurse sanksioni të përgjegjësia deliktore është me karakter pasuror.⁴⁴ Sipas mendimit tjetër faji dhe veprimi i kundërligjshëm bazohet. Shumica e shkencëtarëve në të drejtën nacionale nuk e përkrahin këtë mendim, sepse veprimi antijuridik është kategori objektive, kurse faji është kategori subjektive. Veprimi antijuridik si kategori objektive paraqet një gjendje faktike që është e lidhur me cënimin e ndonjë norme urdhëruese apo ndaluese (norma imperative). Ndërsa faji si kategori e mbrendshme psiqike, ekziston vetem kur personi dëmin e shkakton me vetëdije dhe me vullnet për të krijuar pasojën e dëmshme.

5.1 Shkallët e fajit

Në periudhën klasike romake zhvillimi teorik për fajin nuk ka qenë në nivelin e ditëve të sotme, shpeshherë kjo varej prej çdo rasti veç e veç që mund të jepnin kuptimin e fajit kazuistët romak, që për kohën e atëhershme ishte shprehje e një niveli më të lartë juridik, ndërsa në të drejtat e mëvonshme kjo teori është zhvilluar gjithnjë më tepër. Sipas shkallës së fajit, “dëmi mund të jetë i shkaktuar me dashje (dolus) dhe nga pakujdesia (culpa)”, neni 158 LMD.

Dashja është shkalla më e rëndë e fajit dhe ndodhë atëherë kur dëmtuesi është i vetëdijshëm se me veprimet apo mosveprimet e veta do të shkaktohet dëmi. Në këtë rast dëmtuesi dëshiron dhe i di pasojat e dëmshme të veprimit ose mosveprimit të vet. Kjo ndodh kur nuk pranon diçka që duhet të pranoj ose kur bën diçka që nuk duhet të bëjë. Dashja ndahet në dy kategori: **dashje direkte** (dolus directus) dhe **dashje eventuale ose e rastit** (dolus eventualis).

Dashja direkte – është kur dëmtuesi me qëllim ka ndërmarr sjellje të dëmshme dhe është i vetëdijshëm për pasojat e tij, të cilat dhe i dëshiron, p.sh., dëmi me dashje ndodh kur dikush me qëllim e godet dritaren dhe e then xhamin.

⁴⁴ A.S.Alishani, E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme, Botimi i dytë, Prishtinë, 2002, faqe. 473, 474.

Dashja eventuale – që në disa raste quhet edhe dashja e rastit, ekziston kur dëmtuesi është i vetëdijshëm për pasojat e dëmit që mund të shkaktohen nga veprimi ose mosveprimi i tij, por prap se prap ka lejuar që t’i shkaktohet dëm subjektit tjetër. Kështu, mundë të ndodhë kur dikush drejton armën ndaj shokut, të cilën mendon ta shkrep në ndonjë drejtim tjetër, që ka për qëllim për ta trembur, por fatkeqësisht plumbi kap trupin e shokut. Në rast se shkaktohet dëmi në dashje, detyra e dëmshpërblimit të dëmtuesit do të përfshinte shpërblimin e dëmit në tërësi, pra dëmin e vërtet dhe fitimin e munguar. Përgjegjësia për dëmin e shkaktohet me dolus nuk mund të përjashtohet.⁴⁵

Pakujdesia – Është shkalla e fajit që supozon mospasjen e kujdesit të rregullt të personit. Mospasja e kujdesit mundë të jetë në trajta të ndryshme ku këta trajta i njohin të drejtat e ndryshme nacionale dhe i kanë njohur edhe të drejtat e vjetra. Pakujdesia përcaktohet në mënyrë abstrakte duke u mbështetur në standardet e sjelljeve të njerëzve, siç janë: sjellja e njeriut mesatar ai ekonomist i mirë, si shtëpiak i mir (bonus pater familias), kujdesi i njeriut të rëndomtë.⁴⁶

Format e pakujdesisë janë: a) **Pakujdesia e rëndë** (clupa lata) dhe b) **pakujdesia e rëndomtë** (clupa levis).

Pakujdesia e rëndë është shkalla më e rëndë e pakujdesis dhe kjo shkall e fajit barazohe me dashje-dolus dhe me fajin.

Më këtë pakujdesi dëmtuesi shkakton dëmin duke cënuar kujdesin e rëndomt. Kjo ndodhë kështu për arsye se shkaktohet i dëmit në qarkullimin praktik nuk sillet si njeri i arsyeshëm, që në situat të tillë do të silleshte çdo njeri në nivel dhe vetëdijes së zakonshme. Pakujdesi e rëndë në praktikën gjyqësore është e shpeshtë. Pakujdesi e rëndë është në qoftë se vozitësi e ka vozitur automjetin me shpejtësi të madhe dhe në gjendje të dehur ose kur vozitësi me shpejtësi të madhe hyn në kthesë kalon në anën e kundërt të rrugës dhe shkakton aksident në trafik.

Pakujdesia e rëndomtë (clupa levis) – pakujdesi e rëndomtë ekziston kur dëmtuesi me veprimin e vet nuk ka pasur kujdes të cilin duhet të ket njeriu i kujdesshëm, puntori posaçërisht i kujdesshëm, udhëheqësi posaçërisht i kujdesshëm. Kjo ndodh kur vozitësi gjatë vozitjes futet në parakalim edhe pse shikon veturën që vjen në drejtim të tij por duke njohur veturën e vet dhe shkathtësit e veta mendon se do mund t’ia dalë. Por nëse shkaktohet dëm nga ki veprim atëherë vozitësi do të përgjigjet mbi bazën e shkallës së fajit culpa levis.

⁴⁵ N.Dauti, E drejta e detyrimeve, (pjesa e përgjithshme dhe e veçant), Prishtinë, 2001, faqe. 166.

⁴⁶ Po aty, faqe. 167.

Në pakujdesin e rëndomtë dallohen: **pakujdesia e vetëdijshme, e pavetëdijshme, culpa levis in abstracto, culpa levis in concreto.**

Pakujdesia e vetëdijshme - paraqitet kur personi e ka parapar se me veprimin e tij do ti shkaktoj pasoja të dëmshme personit tjetër por ai këtë nuk e ka dashur dhe as e ka dëshiruar që ato pasoja të shkaktohen duke pretenduar se mund ti evitoj, p.sh., kur një vozitësi bën parakalim në rrugën e cila është e ndalume parakalimi, mirpo ai edhe pse është i vetëdijshëm se një veprim i till është i ndaluar dhe se do të shkakton aksident, mirpo ai përsëri e bën atë duke shpresuar se do ti shmanget aksidentit.

Pakujdesia e pavetëdijshme – ekziston kur dëmtuesi nuk ka qenë i vetëdijshëm se nga sjellja e tij mund të shkaktohet dëm dhe për pasojat e asaj sjellje të cilat ka mundur ta dijë duke marrë parasysh shkallën e aftësisë së vet për gjykim dhe ka qenë i detyruar ta dij se nga sjellja e tij mund të shkaktohet dëm.

Culpa levis in abstracto apo pakujdesia e lehtë abstrakte – është forma e pakujdesisë që ekziston atëherë kur njeriu me veprimet e tij gjatë shkaktimeve të dëmit nuk është sjell si njeri i kujdesshëm, qoftë në raportet e përgjithshme duke pasur kujdes për të mos shkaktuar dëm, apo qoftë në rastin e përmbushjes së detyrimeve kontaktore.⁴⁷ Në praktikën gjyqësore për ekzistimin e kësaj pakujdesie gjykata kërkon që dëmtuesi të ketë ditur për këto pasoja, sepse supozohet se çdo njeri i rëndomtë në këto raste do të mund të jetë i vetëdijshëm.

Culpa levis in concreto apo pakujdesia e lehtë konkrete e kemi kur subjektet në qarkullimin juridik nuk i ndërmarrin ato masa që do të mundë t'i ndërmarrte sikur të bëhej fjalë për mbrojtëjen e interesave të tij personale.⁴⁸ Në këtë rastë pakujdesia e dëmtuesit është më e vogël se kujdesi që tregohet ndaj sendeve të veta. Te kjo pakujdesi gjyqëtari e krahason sjelljen e dëmtuesit gjatë shkaktimeve të dëmit me sjelljen që ai zakonisht e ka ndaj sendeve të veta. Nëse gjyqëtari vërteton se në sjelljet ekziston ndonjë dallim i caktuar atëherë personi do të shpallet fajtor për dëmin e shkaktuar dhe do të përgjigjet për këtë dëm.

⁴⁷ A. Mahmuti, Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit material në Maqedoni (disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor”), Tiranë, mars 2013, faqe. 80.

⁴⁸ Po aty faqe. 80.

KAPITULLI II

II. NË PËRGJITHËSI PËR SHPËRBLIMIN E DËMIT

1 Nocioni i shpërblimit të dëmit

Nëse përgjegjësia penale ka për qëllim dënimin e autorit të veprës penale, përgjegjësia civile e gjen qëllimin e saj në shpërblimin e dëmit. Qëllimi i shpërblimit të dëmit është që ti menjanoj pasojat e dëmshme të dëmit të caktuar. Detyrimi për dëmshpërblim lind në të njëjtën kohë me shkaktimin e dëmit, por kredia që rrjedh nga ky dëm do të mbetet e tillë në potencial, përderisa ajo nuk është njohur vullnetarisht ose konstatuar në rrugë gjyqësore. Që të mund të bëhet fjalë për shpërblimin e dëmit, është e nevojshme që, së pari të ekzistoj dëmi, që të jetë shkaktuar një humbje në pasurinë e dikujt ose, pikërisht, të jetë cënuar ndonjë e drejtë e tij. Shpërblimi i dëmit në të kaluarën ka pasur karakter ndëshkues, kurse tash ka karakter preventive të kompesimit.

Dëmi paraqet cënimin e vlerave materiale apo personale të personit, të cilat janë të mbrojtura juridikisht. Detyrimi për shpërblimin e dëmit paraqitet si sanksion, që në momentin e lindjes së përgjegjësisë civile. Detyrimi për shpërblimin e dëmit bie mbi personin përgjegjës që ka shkaktuar dëmin. Bazuar në rregullat e së drejtës kur dikush dikujt i shkaktonte dëm, është i detyruar që t'ia shpërblej dëmin e shkaktuar, poqese plotësohen dhe kushtet e caktuara. Duke shpërbluar dëmin e shkaktuar, synohet që të vendoset ajo gjendje që ka ekzistuar para momentit të shkaktimit të dëmit. Megjithatë, duhet bërë dallimin ndërmjet shpërblimit të dëmit deliktor nga ai kontraktor, pasi tek shpërblimi i dëmit deliktor detyrimi i debitorit buron nga ligji, kurse tek përgjegjësia kontraktore detyrimi i debitorit buron nga kontrata.

E drejta romake, si një civilizim më i lartë juridik për kohën në të cilën jetoi, ka pasur rregulla shumë të zhvilluara për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar. Edhe në të drejtën e lashtë romake, si në shumë të drejta tjera shpërblimi i dëmit i bëhej personit të dëmtuar. Këtu, mund të përmendim edhe ligjin e XII tabelave (pallakave), i cili për herë të parë me dispozita normative sanksiononte çështjen e shpërblimit të dëmit të shkaktuar nga rrethana të ndryshme.

Sipas rregullave të së drejtës romake midis padrejtësisë së shkaktuar dhe dënimit të caktuar nuk ishte e domosdoshme që të ekzistonte barazia ose ekuivalenca, sepse dënimi nuk shërbente si mjet për zhdëmtim, por si satisfaksion për shkak të padrejtësisë së shkaktuar dhe si lirim nga e drejta e hakmarjes (talioni).⁴⁹ Mirëpo, në të drejtën romake vinte në shprehje edhe liria e tepërt e gjyqtarit me rastin e sjelljes së vendimit për kompensim të dëmit, sepse ai shpeshherë me rastin e shkaktimit të dëmit nisej nga ajo se ç'farë ishte pozita e personalitetit të shkaktuesit të dëmit, pastaj personaliteti i të dëmtuarit, vlera pasurore apo personale e rrezikuar, pasojat e krijuara, si dhe koha dhe vendi i shkaktimit të dëmit, dhe pasi i merrte parasysh gjithë këto faktor, atëherë sillte dhe vendimin i cili mbështetej thjeshtë në vullnetin dhe bindjen e lirë të gjyqtarit, që shpesh herë ishte dhe shumë subjektiv. Edhe sot, gjykatësi me rastin e sjelljes së vendimit për shpërblimin e dëmit i referohet asaj që është e drejtë objektive në një vend, duke marrë për bazë plotësimin e kushteve për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar, me ç'rast lind dhe detyrimi i dëmtuesit për shpërblim të dëmit. Bazë e përgjegjësisë, për detyrimin për shpërblimin e dëmit të një personi të caktuar është vetë fakti i shkaktimit të dëmit.

Kjo parashihet edhe me nenin 141 të LMD-së sipas të cilit ai i cili i shkakton dëm tjetrit është i detyruar që ta shpërblej. Qëllimi i detyrimeve nga shkaktimi i dëmit është shpërblimi i dëmit pasuror që ka pësuar i dëmtuari.⁵⁰ Me termin shpërblim të dëmit, nënkuptojmë detyrën juridike me të cilën ngarkohet dëmtuesi që të shpërblejë subjektin e dëmtuar qoftë në aspektin material qoftë në atë moral. Shpërblimin e dëmit në parim e bën dëmtuesi ose subjekti përgjegjës, kurse kërkesën për shpërblim në parim e parashton personi i dëmtuar. Detyrimi i dëmtuesit rrjedh nga rregullat e së drejtës objektive, gjithashtu edhe kërkesa e palës së dëmtuar për shpërblim të dëmit bazohet në rregullat e së drejtës objektive. Edhe legjislacioni i Maqedonisë sikurse shumica e legjislacioneve të huaja siç është ai i Gjermanisë, Shqipërisë, Kodi Civil i Francës apo Kodi Civil i Austrisë parashohin detyrimin e shpërblimit të dëmit në natyrë, pavarësisht se a kemi të bëjmë me dëm kontraktor apo deliktor. Kështu mund të përmendim nenin 174 të LMD-së ku kërkon që “Personi përgjegjës është i detyruar që ta vendos gjendjen që ekzistonte para shkaktimit të dëmit”, dhe vetëm në qoftë se kjo nuk është e mundur, atëherë gjykatësi për të riparuar pasojën e dëmit do të vendos që shpërblimi i dëmit të bëhet me para. Megjithatë, detyrimi për shpërblim të dëmit nuk është çështje e vullnetit të subjektit përgjegjës, sikundër që është kërkesa e të dëmtuarit,

⁴⁹ P.Ivo, E drejta romake, Prishtinë, 1989, faqe. 304.

⁵⁰ S.Petroviç, E drejta e Detyrimeve, Beograd, 1973, faqe. 304.

e cila varet ekskluzivisht nga vullneti i tij. Pra, shpërblimi i dëmit nuk ka për qëllim që të shton pasurin e subjektit të dëmtuar, e as ta vë në pozite varfërie subjektin përgjegjës.

2.2 Qëllimi i shpërblimit të dëmit

Qëllimi i përgjegjësisë pasurore-juridike nuk është dënimi, por riparimi i dëmit të shkaktuar, çka do të thotë se si synim i të drejtës moderne është jo përgjegjësia, por mënjanimi i veprimeve dhe pasojave të dëmshme.⁵¹ Esenca qëndron në atë se riparimi i dëmit me anë të shpërblimit të tij, për tu krijuar gjendja që ka ekzistuar përpara shkaktimit të dëmit. Çështja e çastit të detyrimit për shpërblim të dëmit dhe prezumimet procedurale, zënë vend të rëndësishëm në doktrinën juridike. Në kontekst të kësaj, mund të potencohet se në doktrinën juridike janë krijuar mendime të ndryshme lidhur me çastin e detyrimit të shpërblimit të dëmit. Sipas njërit mendim, detyrimi për shpërblim të dëmit lind me sjelljen e vendimit të plotëfuqishëm nga ana e gjykatës. Me përmbajtje tjetër fare është krijuar mendimi se detyrimi për shpërblim të dëmit lind në çastin e shkaktimit të dëmit. Për dallim nga ky dualizëm, për përcaktimin e çastit të detyrimeve për shpërblim të dëmit, lidhur me prezumimet procedurale, në doktrinën juridike është ngritur një qëndrim unik si në vijim: personi i dëmtuar që të realizoj të drejtat e tija në ushtrimin e kërkesës për shpërblim të dëmit, duhet të vërtetojë, se ka përjetuar dëmin në rastin konkret dhe se kjo realizohet në procedurë kontestimore me një vendim të plotëfuqishëm gjyqësorë. Kompensimi i dëmit bëhet në bazë të dorzimit të padis për kompensim të dëmit. Kësaj padie i paraprin padia për vërtetimin e shkeljes apo cenimit të së drejtës.⁵²

Praktika gjyqësore dhe legjislacioni i Maqedonisë mbështetet në teorinë se përgjegjësia për shpërblim të dëmit lind në momentin e shkaktimit të dëmit. Kjo bazohet edhe në nenin 175 të LMD-së, sipas të cilit detyrimi për shpërblim të dëmit llogaritet se krijohet nga momenti i shkaktimit të dëmit. Përmes shpërblimit të dëmit, përveç që synohet të riparohen pasojat e dëmit, gjithashtu sanksioni i tillë ka për qëllim në një aspekt edhe ndëshkimin e personit përgjegjës që ka shkaktuar dëmin për shkak të veprimeve të fajshme apo për shkak të pakujdesisë në lëshimet eventuale që mund t'i ndodhin. Mënyra e shpërblimit të dëmit që shqiptohet si ndëshkim ndaj subjektit përgjegjës ka qenë karakteristike për periudhat e hershme të zhvillimit të shoqërisë. Por sot, ky qëndrim nuk vjen në shprehje pasi kemi situata ku person tjetër e shkakton dëmin, ndërsa një subjekt i

⁵¹ M.J.Hetemi, E drejta me njohuritë themelore të së drejtës afariste, Prishtinë, 2002, faqe. 103.

⁵² A.Jashari, E drejta afariste kontraktore, Tetovë, 2016, faqe. 556.

tretë është i detyruar që ta shpërblej, dhe se shpërblimi i dëmit sot ka për synim riparimin e pasojës së dëmshme.

Me realizimin e shpërblimit të dëmit, pasojat e dëmit kalojnë definitivisht në anën e personit që ka shkaktuar dëmin, sepse tani për personin e dëmtuar ose kthehet gjendja e mëparshme ose merr shpërblimin në të holla, duke marrë parasysh dëmin të cilin e ka pësuar.⁵³

Që të konsiderohen të zhdëmtuara pasojat e dëmit, duhet që në tërësi të shpërblehet i gjithë dëmi, si dëmi real ashtu edhe fitimi i munguar. Po që se shohim praktikën gjyqësore sot, do të vërejmë se janë shumëfishuar rastet e kontesteve që zhvillohen pranë gjykatave për shpërblim të dëmit. Po që se vërejmë vetëm nëpër gjykatat e Francës përqindja e lëndëve civile për të cilat zhvillohet procedurë kontestimore për shpërblim dëmi te disa gjykata arrin deri në 75% të lëndëve, që do të thotë se çdo dy sekonda (duke llogaritur ditët e punës) hapet nga një lëndë e re për shpërblim dëmi.⁵⁴ Edhe në Maqedoni, numri më i madh kontesteve civile kanë për bazë shpërblimin e dëmit. Këtë mund ta konstatojmë në qoftë se vërejmë raportin e lëndëve civile në Gjykatën Themelore të Tetovës për vitin 2012. Poashtu, gjatë vitit 2011 në Gjykatën Supreme të Maqedonisë në sektorin civil ka pasur për zgjidhje 3154 lëndë, nga të cilat 1466 lëndë të pazgjidhura janë nga vitet paraprake dhe vetëm 1688 janë parashtruar në vitin 2011. Nga këto janë zgjidhur 1132 dhe, kanë mbetur 2022 lëndë të pazgjidhura.⁵⁵ Më poshtë do të paraqesim një tabel me vendimet e gjykatës themelore të Tetovës për vitin 2012 sektori civil.

Vendime të Gjykatës Themelore të Tetovës për vitin 2012 Sektori civil		
Vendime për shpërblim dëmi	106	7%
Vendime për konteste nga marrëdhënia e punës	169	10%
Vendime për çështje pronësie dhe borxheve	752	45%
Vendime për konteste me vlerë të vogël⁵⁶	327	20%
Vendime për shkurorëzim	326	45%

Për çështjen e shpërblimit të dëmit përdoren emërtime të ndryshme, por që të gjitha afërsisht kanë po të njëjtin kuptim. Kështu, përveç shprehjes shpërblim të dëmit, në literatur

⁵³ A.S.Alishani, E drejta e detyrimeve, Pjesa e përgjithëshme, faqe. 533.

⁵⁴ P.Klarić, “Odštetno pravo”, Zagreb, 2003, faqe. 3.

⁵⁵ Të dhënat janë siguruar nga Gjykata Themelore e Tetovës dhe nga Raporti i Punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë për vitin 2011.

⁵⁶ Në kuadër të vendimeve gjyqësore me vlerë të vogël përfshihen të gjitha kontestet civile që nuk kalojnë vlerën prej 1.800,00 denarë.

hasen dhe emërtime si kompensim i dëmit, riparim i dëmit, riparim i pasojave të dëmshme, rregullim i dëmit, zhdëmtim i dëmit apo shpagim i dëmit. Ka mendime të ndryshme nga autorë të caktuar, që shprehin preferenca në lidhje me shprehjen që duhet përdorur për situata të caktuara. Kështu, disa mendojnë se shprehja riparim i dëmit është term më adekua për këtë situatë, mirëpo kjo shprehje më shumti i përshtatet situatave kur bëhet kthimi në natyrë dhe sikur përjashton rastet e shpërblimit të dëmit me para. Shprehja kompensim dëmi duket më gjithëpërfshirëse, pasi përfshin të gjitha format e shpërblimit të dëmit. Shprehja kompensim origjinën e ka që nga e drejta romake “compensare” dhe termi i njëjtë është përshtatur në shumicën e gjuhëve europiane me po të njëtin kuptim, në anglisht compensation, në frengjisht poashtu. Legjislacioni shqiptar përdor shprehjen shpërblim dëmi, që në dukje të parë të lë përshtypjen se kjo shprehje përdoret vetëm për dëmet jashtëkontraktore dhe sikur i përjashton dëmet që mund të burojnë nga kontrata. Poashtu, me këtë term mund të mendohet vetëm për shpërblimin me para të dëmit dhe jo dhe formën e kompensimit në natyrë të tij, psh: kthimi i sendit të vjedhur. Shprehja shpërblim i dëmit në përkthim është sinonim i shprehjes kompensim dhe mendoj që do të ishte në rregullt që edhe studjuesit e së drejtës civile, në gjuhën shqipe të përdorin po këtë emërtim, meqë me këtë do të unifikonim këtë si shprehje kryesore për të emërtuar këto situata. Personi përgjegjës mundet “grosso modo” (në mënyrë të përafërt) që të jetë i detyruar të shpërblejë dëmin në tri forma, edhe atë: restituim të dëmit, kompensim me para dhe satisfaksion.⁵⁷ Por, kjo varet nga situatat se a kemi të bëjmë me dëmin material apo jomaterial. Gjithashtu, gjykatësi ka të drejtë që në procedurë penale, pas shpalljes së fajësisë së personit, me të njëjtin aktgjykim të vendos edhe për kërkesat e karakterit pasuror që mund të ketë pala e dëmtuar. Për këto kërkesa, gjykatësi mund të vendos në tërësi për dëmin civil të shkaktuar, por mund të vendos edhe vetëm pjesërisht, dhe për pjesën tjetër të kërkesës së mbetur ta udhëzon palën që të zhvillojë kontest civil. Poashtu, edhe në qoftë se gjykatësi penal, provat materiale për vendosjen e shpërblimit civil të dëmit, nuk i ka të mjaftueshme apo nuk kanë bazë të qartë, atëherë palën e dëmtuar do ta udhëzonte që këtë të drejtë t’u realizoj në procedurë civile. Vendimi gjyqësor, i sjellë në procedurë penale me të cilin është vendosur që të pranohen kërkesat e karakterit pasuror të palës së dëmtuar, paraqet dokument të ekzekutueshëm, dhe e njëjta, mund të realizohet në procedurës përmbaruese.

⁵⁷ O.Antiç, E Drejta e Detyrimeve, Beograd, 2011, faqe. 515.

2.3 Shpërblimi i dëmit material

Në të drejtën detyrimore ekziston një rregull e përgjithshme sipas së cilës, çdokush është përgjegjës për veprimet e veta dëmtuese lidhur me shpërblimin e dëmit të shkaktuar ndaj personit tjetër. Me termin shpërblim të dëmit, nënkuptojmë detyrën juridike me të cilën ngarkohet dëmtuesi që të shpërblejë subjektin e dëmtuar qoftë në aspektin material qoftë në atë moral. Që të ekzistojë përgjegjësia për shpërblimin e dëmit, duhet të plotësohen këto kushte: të ekzistojë dëmi, që dëmi të jetë shkaktuar me veprim ose lëshim të kundërligjshëm të dëmtuesit, që të ekzistojë faji i dëmtuesit dhe të ekzistojë lidhja shkakësore mes veprimit dëmtues dhe pasojave - dëmit

Shpërblimi i dëmit material paraqet mënjanimin e pasojave të dëmshme që paraqiten nga veprimi i dëmshëm i dëmtuesit ndaj vlerave pasurore të të dëmtuarit. Shpërblimi i dëmit material poashtu përfshin edhe cënimin e integritetit të personit, dhe që përfshin rastin e vdekjes së personit, lëndimet trupore, përhapjen e informacioneve të pavërteta për dikend si dhe cënimin e nderit. Prandaj, thuhet se çdo dëm, i cili shprehet në pasurinë e të dëmtuarit dhe në integritetin personal të personit, paraqet dëmin material. Kështu, në LMD të Maqedonisë në nenin 187 thot personi që dëmton nderin e një tjetri, si dhe ai që paraqet ose përcjell pretendime të pavërteta për të kaluarën, njohuri, aftësi të një personi tjetër ose diçka tjetër dhe e dinte ose duhet ta kishte ditur se ata janë të pavërtetë dhe me të shkakton dëm material, është i detyruar të kompensojë.⁵⁸ Shpërblimi i dëmit material konsiderohet se ka për qëllim të bëjë riparimin e dëmit, pasi me këtë synohet të vendoset gjendja e para shkakimit të dëmit, duke eliminuar pasojat e shkaktuara prej tij. Por, në masë të caktuar ka edhe funksion preventiv, për shkak se “kërcënimi” se dëmi do të shpërblehet në një formë të caktuar, ndikon te personat të cilët paraqiten si dëmtues potencial që të përmbahen nga veprimet me të cilat personave të tjerë do tu shkaktonin dëm.⁵⁹ Në të gjitha këto raste, personi përgjegjës ka për detyrë ta restitujë gjendjen që ka ekzistuar para se të shkaktohej dëmi, qoftë duke kthyer situatën në gjendjen e mëparshme, nëse kjo është e mundur, apo shpërblimin në të holla. Detyrimi për shpërblim të dëmit kryesisht bie mbi dëmtuesin, dhe, vetëm përjashtimisht, njihen rastet e shpërblimit të dëmit nga subjekti tjetër përgjegjës, siç mund të jetë prindi apo kujdestari për dëmin që shkakton fëmija, personi juridik për dëmin e shkaktuar nga punëtori i tij ose kompania e sigurimeve për dëmin e siguruar. Shpërblimi i dëmit material mund të realizohet para gjykatës civile, ku inicohet procedur e vaçant.

⁵⁸ Neni 187 i LMD-së të Maqedonisë.

⁵⁹ G.Galev&J. D. Anastasovska, “Obligaciono pravo”, Shkup, 2009, faqe. 748.

Shpërblimi i dëmit material mund të realizohet në dy mënyra:

- ✓ me kthim në gjendjen e mëparshme (shpërblim në natyrë) dhe,
- ✓ shpërblim në të holla.⁶⁰

2.3.1 Dëmshpërblimi në natyrë

Kthimi në natyrë është një ndër format themelore të shpërblimit të dëmit material. Dëmshpërblimi në natyrë bëhet me kthimin në gjendjen e mëparshme pra në gjendje të njejtë natyrore ashtu siç ka qenë objekti (lënda) para shkakimit të dëmit.⁶¹ Ky shpërblim bëhet me kthimin e sendit në atë gjendje që ka qenë para se të shkaktohet dëmi. Në rastin e dëmtimit të shëndetit, kthimi në gjendje të më parshme bëhet me përmirsimin e shëndetit të të dëmtuarit ose aftësimin e tij për punën që ka kryer më parë. Mënjanimi i pasojave të dëmshme jo rrallë herë bëhet me anë të shpërblimit të dëmit në natyrë. Dëmshpërblimi në natyrë realizohet me kthim në gjendjen e më parshme “*restitutio in integrum in natura*”. Variantin e kthimit në gjendjen e më parshme e njeh dhe Kanuni i Lekë Dukagjinit, ku thuhet: “Po bani dam kush me gja n’arë, në kopshtë, në vneshtë a në livadh, i zoti i gjasë do t’a ndreqë të damtuemin me bimë për bimë të damtueme”.⁶² Këtë variant të shpërblimit të dëmit e njeh edhe legjislacioni pozitiv i Maqedonisë, në nenin 174 të LMD. Ky legjislacion ku kërkon nga personi përgjegjës që ta vendosë gjendjen që ekzistonte para shkakimit të dëmit, dhe vetëm në qoftë se kjo nuk është e mundur, atëherë gjykatësi për të riparuar pasojën e dëmit do të vendosë që shpërblimi i dëmit të bëhet me të holla. Sipas legjislacionit të Maqedonisë, kthimi në natyrë ka përparësi në raport me shpërblimin me para të dëmit. Nga kjo shihet se kjo dispozitë është e karakterit dispozitiv, pasi le mundësinë që palët të merren vesh edhe ndryshe, dhe vetëm në mungesë të marrëveshjes, vjen në shprehje zbatimi i kësaj dispozite. Kthimi në gjendjen e mëparshme në pasurinë e të dëmtuarit bëhet me kthimin e sendit në atë gjendje në të cilën ka qenë para se të shkaktohet dëmi. Kjo formë e riparimit të dëmit, përveç kthimit në gjendjen e para shkakimit të dëmit, bëhet edhe me dorëzimin e sendit të njëjtë, nëse është send i paharxhueshëm. Kurse, nëse bëhet fjalë për sende që për nga natyra janë të harxhueshme, kthimi në gjendjen e mëparshme bëhet duke dorëzuar sendin e llojit të njëjtë, sasinë e njëjtë me kualitet të njëjtë apo të përafërt. Shpërblimi në natyrë i dëmit bëhet vetëm nëse nuk është e mundur realizimi i formave të tjera të shpërblimit të dëmit, si dhe nëse format tjera nuk i

⁶⁰ N.Dauti, E drejta e detyrimeve, Prishtinë, 2001, faqe. 196.

⁶¹ G.Galev, Jadranka Doboviq Atanasovska, Obligaciono pravo, Shkup, 2008, faqe. 638.

⁶² Krye i pesembdhetet, nye i tetedhetepare, pika 494 e Kanunit të Lekë Dukagjinit.

përgjigjen dëmtuesit. Riparimi ose kthimi i sendit në gjendje të mëparshme, konsiston në arritjen e gjendjes së njëjtë që ka ekzistuar para shkaktimit të dëmit. Prandaj, në bazë të kësaj që nënvizojmë, nënkuptojmë se shpërblimi i dëmit material në natyrë mund të bëhet në dy mënyra: vendosjen e gjendjes e cila ekzistonte përpara shkaktimit të dëmit dhe, dorëzimin e sendit të llojit të njëjtë, të sasisë dhe kualitetit të njëjtë në emër të personit që i shpërblehet dëmi.⁶³ Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit. Gjykata do t'i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme. Pra, kthimi në natyrë paraqet një formë jo të rrallë të shpërblimit të dëmit material.

Riparimin mund të bëjë vetë dëmtuesi apo personi tjetër në emër dhe për llogari të dëmtuesit. Vetëm dëmi real mund të kompensohet mbi bazën e kësaj forme, ndërkaq fitimi i munguar për shkak të natyrës nuk mund të kompensohet me kthimin në natyrë. Kjo mënyrë e riparimit të dëmit mund të aplikohet te shkaktimi i dëmit të vërtetë (real) si lloj i dëmit material. Aplikimi i restitucionit natural bëhet çdo herë kur dëmtuesi që e ka dëmtuar sendin e të dëmtuarit, e bën riparimin e tij ose në vend të tij i jep tjetër me vlerë dhe lloj të njëjtë, atëherë themi se është aplikuar shpërblimi i dëmit në natyrë. Nuk mund të aplikohet çdoherë shpërblimi i dëmit në natyrë, parasegjithash kur sendi i dëmtuar nuk mund të riparohet e as të zëvendësohet ose kur ai është res in specie – send individualisht i caktuar. Ndërkaq, në të gjitha rastet kur është dëmtuar një send që sipas gjinisë paraqet send gjenerik, kthimi në natyrë përveç riparimit të mundshëm mund të zbatohet edhe me zvendësimin e sendit të dëmtuar me një send tjetër.

2.3.2 Shpërblimi i dëmit në para

Në rastet kur nuk mund të evitohen në tërësi pasojat e dëmit me kthim në gjendje të mëparshme, kur kthimi në gjendje të mëparshme, nuk është i mundur dhe kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshëm kthimi në gjendje të mëparshme, atëherë shpërblimi i dëmit bëhet në të holla. Shpërblimi i dëmit në të holla, ka përparësitë e veta ndaj

⁶³ Ž.S.Đorđević & Vladan S.Stanković, “E drejta e Detyrimeve” - Pjesa e përgjithshme, Edicioni i dytë, Beograd, 1976, faqe. 399.

shpërblimit në natyrë, sepse shpeshherë në praktik me kthim në gjendje të mëparshme nuk është arritur gjendja as për së afërmi e asaj që ekzistonte më parë, e lëre më të kthehet gjendja tërësisht siç ka qenë para shkaktimit të dëmit. Shpërblimi i dëmit në të holla është më i shpeshtë edhe për faktin se paraja mund të paraqitet si ekuivalent i çdo vlere materiale dhe jomateriale të dëmtuar, me çka me para mund të zëvendësohet kryesisht çdo vlerë sendit të humbur apo dëmtuar pra shpërblimi qendron në pagimin e një sasive të hollash për të baraspeshuar një dëm, i cili nuk mund të ndreqet në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Shpërblimi në të holla paraqet kthimin vlerësor të sendit të dëmtuar. Në fakt, shpërblimi në para, paraqet shumën e caktuar të parave që i jepet të dëmtuarit në vend të sendit të asgjësuar, për të mundur ta blejë sendin e llojit të njejtë. Shuma në para paraqet vlerën e sendit që ka ekzistuar para shkaktimit të dëmit. Gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim. Pra, shpërblimi i dëmit me të holla është pagimi i dëmit me të holla si barasvlerë e përgjithshme.⁶⁴

Në kuadër të shpërblimit në të holla bënë pjesë edhe shpërblimi në formë të rentës në të holla. Në rast të vdekjes, të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit, shpërblimi caktohet, sipas rregullës, në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar. Renta në të holla e gjykuar në emër të shpërblimit të dëmit paguhet për çdo muaj përpara, në qoftë se gjykata nuk cakton diç tjetër. Gjykata mundet me kërkesë të të dëmtuarit, që për të ardhmen ta rritë rentën, por mundet me kërkesë të dëmtuesit ta zvogëlojë ose ta heq, në qoftë se kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme rrethanat të cilat gjykata i ka pasur parasysh me rastin e nxjerrjes së vendimit të mëparshëm. Kreditori ka të drejtë të kërkojë sigurim të nevojshëm për pagimin e rentës, përveç nëse kjo sipas rrethanave të rastit nuk do të ishte e arsyeshme. Në qoftë se debitori nuk e jep sigurimin të cilin e cakton gjykata, kreditori ka të drejtë të kërkojë që në vend të rentës t'i paguhet një shumë e përgjithshme, lartësia e të cilit do të caktohet sipas lartësisë së rentës dhe kohëzgjatjes së mundshme të jetës së kreditorit, me zbritje të kamatave përkatëse. Për shkaqe serioze kreditori mundet edhe në raste të tjera të kërkojë menjëherë ose më vonë, që në vend të rentës t'i paguhet një shumë e përgjithshme. Është me rëndësi të përmendet se shpërblimi i dëmit me të holla gjenë zbatim në të gjitha rastet kur sendi ka marrë dëmtime të mëdha deri në atë shkallë sa që është e pamundur që të zbatohet kthimi në natyrë. Në këto raste, shpërblimi i dëmit mund të arrihet

⁶⁴ N.Dauti, E drejta e detyrimeve, Prishtinë, 2001, faqe. 197.

me dhënje të njehershme të shpërblimit në të holla në vlerë të caktuar dhe me dhënje suksesive të cilat paraqiten si rentë në të holla. Renta në të holla në mënyrë suksesive zbatohet te shpërblimi i dëmit material që përfshinë shpenzimet e vdekjes, lëndimit trupor apo dëmtimit të shëndetit. Ndryshe nga renta në mënyrë suksesive, tek renta në mënyrë të njehershme, dhënja e shumës së parave në emër të shpërblimit të dëmit, jepet menjëherë e jo në mënyrë suksesive. Pra, shpërblimi i dëmit në të holla do të zbatohet përherë kur sendi i dëmtuar nuk mund të kthehet në gjendjen e mëparshme në mënyrë të plotë. Në qoftë se sendi i dëmtuar mund të kthehet pjesërisht në gjendjen e mëparshme, atëherë pjesa tjetër e dëmit shpërblehet me të holla. Po ashtu, shpërblimi me para realizohet edhe në rastet kur i dëmtuari e kërkon një formë të tillë të shpërblimit të dëmit, kurse rrethanat e rastit të shkaktuar nuk e arsyetojnë kthimin në natyrë, si dhe në rastet kur gjykata vlerëson se kthimi në natyrë do të shkaktojë shpenzime të mëdha për personin përgjegjës.

2.4 Kriteret për caktimin e lartësisë së dëmshpërblimit

Lartësinë e shumës së parave për shpërblimin e dëmit e cakton gjykata kompetente në kontest civil. Kur kemi të bëjmë me shpërblimin e dëmit material, i njëjti duhet të përmbushet në tërësi, sikurse dëmi real, poashtu edhe fitimi i munguar. Ndërsa kur jemi te shpërblimi i dëmit jomaterial, për dallim nga e kaluara, ku me rastin e caktimit të shpërblimit, gjykatësit ndonjëherë sillnin vendime shumë subjektive dhe arbitrare, sot janë përcaktuar disa kriteret edhe, me rastin e vlerësimit të të mirës jomateriale të dëmtuar. Gjykatësi me rastin e përcaktimit të intensitetit të dëmtimit trupor duhet të ketë kujdes që mos të gjykojë edhe për raste të lëndimeve apo gërvishtjeve të vogla, pasi kjo do të shërbente vetëm për komercializëm dhe jo për ndreqje të pasojave të dëmit. Prandaj, nuk duhet secilës situatë ti bëhet mbrojtje juridike civile. Megjithatë, gjykatësi asnjëherë nuk mund të arrijë në mënyrë të përpiktë të përcaktojë vlerën e dëmit jomaterial, për shkak të karakterit personal që ka ky dëm. Këto kriteret për matjen dhe vlerësimin të dëmit jomaterial, kryesisht janë nxjerrur me iniciativë të shoqërive të sigurimeve, pasi edhe rastet më të shpeshta të shkaktimit të dëmit jomaterial vijnë nga aksidentet me mjete motorike, dhe në mungesë të kriterëve matëse për shpërblimin e dëmit, këto konsideroheshin më të dëmtuara.

Gjatë zhvillimit të këtij procesi, gjykata duhet të ketë parasysh rrethanat që do të merren për bazë me rastin e caktimit të lartësisë së shpërblimit të dëmit në të holla, të cilat janë: vlera e të mirës pasurore apo personale të cënuar, faji i dëmtuesit dhe i palës së

dëmtuar, gjendja pasurore e dëmtuesit dhe e të dëmtuarit. Këtu, gjithashtu duhet të merret parasysh edhe fakti se e mira materiale e dëmtuar a ka ndonjë vlerë afeksionale apo individuale për të dëmtuarin (pretium affectionalis, pretium singulare), rëndësinë e të mirës jomateriale të dëmtuar si dhe rrethana tjera që mund të jenë me influencë me rastin e caktimit të shpërblimit. Pastaj duhet të shifet se dëmin, dëmtuesi e ka shkaktuar duke qenë në punë dhe duke punuar për personin të cilit i është shkaktuar dëmi, që lartësia e të njëjtit të mund të rritet apo ulet. Përcaktimi i dëmit jomaterial, si dëm që mund t'i shkaktohet shëndetit ose jetës së njeriut, për dallim nga dëmi material, është shumë më vështirë për tu llogaritur. Në kuadër të kësaj bën fjalë dhe neni 646 i KCSH, ku thuhet: “Për një person që nuk ka qenë në marrëdhënie pune ose nuk ka qenë i siguruar, masa e shpërblimit të dëmit të rrjedhur nga vdekja ose dëmtimi i shëndetit, caktohet nga gjykata në bazë të pagës që merr një punonjës i asaj kategorie me të cilën mund të barazohet edhe puna që kryente ose mund të kryente i dëmtuari”. Element tjetër i rëndësishëm në caktimin e lartësisë së shpërblimit, është edhe çasti i arritjes së detyrës për shpërblim, për të cilën në doktrinën juridike ekzistojnë tri zgjidhje:

- a) shpërblimi i dëmit duhet të llogaritet nga çasti i shkaktimit të dëmit,
- b) shpërblimi i dëmit duhet të llogaritet nga çasti i parashtrimit të padisë dhe
- c) shpërblimi i dëmit duhet të llogaritet nga çasti i marrjes së vendimit gjyqësor.

Praktika gjyqësore e Maqedonisë këtë problematikë e ka zgjidhur, duke u thirrur në nenin 175 të LMD-së ku thuhet: “Detyrimi për kompensim të dëmit llogaritet se buron nga momenti i shkaktimit të dëmit”. Se si do të zgjidhet lartësia e shpërblimit të dëmit, kur të dëmtuarit do t'i shkaktohet dëm edhe për të ardhmen, këtë më së miri e parasheh neni 192 i LMD-së të Maqedonisë, ku thuhet: “Gjykata me kërkesë të palës së dëmtuar do të gjykoj shpërblimin e dëmit të ardhshëm jomaterial nëse sipas rrjedhës së rregullt të gjërave është e sigurt se ai do të vazhdojë edhe në të ardhmen”. Kështu, nëse është shkaktuar vdekja e personit, dëm i ardhshëm është ai dëm që pëson fëmija si rezultat i humbjes së prindit, dhimbjen e të cilës nuk ka qenë në gjendje ta gjykojë në momentin e vdekjes së prindit. Nëse kalon një kohë më e gjatë nga shkaktimi i dëmit deri te kompensimi i tij, mund të paraqiten rrethana të cilat determinojnë rritjen apo uljen e lartësisë së shpërblimit të dëmit. Kështu, gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që kanë lindur pas shkaktimit të dëmit, do të gjykojë kompensimin në një shumë që nevojitet që gjendja materiale e të dëmtuarit të sjellet atje ku do të ishte, po të mos kishte ndodhur lëshimi apo veprimi i dëmshëm.⁶⁵

⁶⁵ Neni 179, i LMD-së të Maqedonisë.

Lartësia e shpërblimit të dëmit të vërtet me para, duke u mbështetur në të gjitha kriteret subjektive dhe objektive, përcaktohet sipas çmimeve që ekzistojnë në kohën e sjelljes së vendimit gjyqësor, përderisa me ligj nuk është përcaktuar diçka tjetër.⁶⁶ Kjo parashifet edhe me paragrafin 2 të nenit 178 të LMD-së, sipas të cilit “Lartësia e shpërblimit të dëmit përcaktohet sipas çmimeve në kohën e sjelljes së vendimit gjyqësor, përderisa diçka tjetër nuk është paraparë me ligj”. Në qoftë se sendi ka pasur vlerë të veçantë për personin, atëherë do të llogaritet edhe vlera afeksionale e sendit, në qoftë se dëmtimi i tij është shkaktuar me paramendim. Shumë më vështirë është për gjyqtarin kur duhet të caktojë lartësinë e fitimit të humbur, për dallim nga shpërblimi i dëmit të vërtetë. Në rastet kur duhet të bëhet shpërblimi i fitimit të munguar, atëherë lartësia duhet të përcaktohet në bazë të asaj që mund të fitonte personi, sikur të mos i ishte shkaktuar dëmi. Por, edhe këtu gjykatësi do të bazohet në nenin 178, pika 3 të LMD-së të Maqedonisë, i cili thotë: “Gjatë vlerësimit të shumës të fitimit të humbur merret në konsiderim fitimi që ka mundur realisht të pritej sipas rrjedhës së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, realizimi i të cilës është penguar nga veprimi i dëmshëm apo lëshimi i dëmtuesit”. Gjithashtu, gjyqtari mundet dhe ta zvogëlojë lartësinë e shpërblimit në më pak se sa vlera e dëmit të shkaktuar te përgjegjësia subjektive, nëse gjendja materiale e të dëmtuarit është e mirë, kurse e dëmtuesit e vështirë dhe nëse dëmi nuk është shkaktuar me dashje apo nga pakujdesia e rëndë e personit. Pra, e rëndësishme është që gjyqtari, me rastin e caktimit të lartësisë së shpërblimit të dëmit, duhet të mundohet që në mënyrë sa më adekuate shpërblimi t’i përgjigjet vëllimit të dëmit që ka pësuar i dëmtuari dhe rrethanave të rastit konkret.

2.5 Rastet e veçanta të shpërblimit të dëmit material

Përgjegjësia civile mund të shkaktohet nga situata të veçanta që ndodhin në jetën e përditshme, qoftë nga përdorimi i sendeve të rrezikshme, poashtu edhe nga aktivitetet e rrezikshme. Disa raste të lindjes së përgjegjësisë civile për shkaktimin e dëmit kanë qenë të njohura që më herët, kurse disa të tjera janë paraparë me dispozita të veçanta ligjore. LMD-ja, nga neni 164 deri tek neni 173, ka paraparë disa situata nga të cilat për personin e caktuar lind përgjegjësia për shpërblimin e dëmit, edhe atë:

- ✓ përgjegjësia juridike civile në rastet e fatkeqësisë të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje;

⁶⁶ D.P.Georgiev, Obligaciono pravo, Shkup, 1985, faqe. 456.

- ✓ përgjegjësia juridike civile e prodhuesit të sendit me të meta;
- ✓ përgjegjësia juridike civile për shkak të akteve terroriste, demonstratave dhe manifestimeve publike;
- ✓ përgjegjësia juridike civile për shkak të veprave të korrupsionit;
- ✓ përgjegjësia juridike civile për dëmin nga veprat penale të dhunshme;
- ✓ përgjegjësia juridike civile për dëmin e shkaktuar nga organizatat ndërkombëtare të luftës apo organizatat e tjera;
- ✓ përgjegjësia juridike civile e organizatorit të manifestimeve festive;
- ✓ përgjegjësia juridike civile për shkak të mosdhënies të ndihmës së parë të domosdoshme;
- ✓ përgjegjësia juridike civile në lidhje me detyrimin për lidhje të kontratës;
- ✓ përgjegjësia juridike civile në lidhje me kryerjen e punëve me interes publik;
- ✓ përgjegjësia juridike civile për dëmin e shkaktuar nga marrëdhënia e punës;
- ✓ përgjegjësia juridike civile për dëmin e shkaktuar nga organet shtetërore apo nëpunësit shtetëror;
- ✓ përgjegjësia juridike civile për dëmin e shkaktuar nga institucionet mjekësore dhe punonjësit mjekësor;
- ✓ përgjegjësia juridike civile për dëmin e shkaktuar për shkak të ndotjes së ambientit jetësor;
- ✓ përgjegjësia juridike civile për dëmin e shkaktuar nga shpifja dhe
- ✓ përgjegjësia juridike civile për dëmin e shkaktuar nga kafshët;

Përveç rasteve të lartë përmendura të parapara me dispozitat e LMD-së, disa situata tjera janë të parapara edhe nëpër dispozitat e ligjeve të tjera, sikurse janë: përgjegjësia juridike civile për dëmin e shkaktuar nga marrëdhënia e punës, përgjegjësia juridike civile për dëmin e shkaktuar nga organet shtetërore apo nëpunësit shtetëror, përgjegjësia juridike civile për dëmin e shkaktuar nga lojërat sportive, përgjegjësia juridike civile për dëmin e shkaktuar nga sendet që bien ose hidhen nga objekti ose nga rrjedhjet nga objekti, përgjegjësia juridike civile për dëmin e shkaktuar nga institucionet mjekësore dhe punonjësit mjekësor, përgjegjësia juridike civile për dëmin e shkaktuar gjatë gjuetisë, përgjegjësia juridike civile për dëmin e shkaktuar për shkak të ndotjes ekologjike, përgjegjësia juridike civile për dëmin e shkaktuar nga përdorimi i drogave farmaceutike, përgjegjësia juridike civile për dëmin e shkaktuar nga kafshët, përgjegjësia juridike civile për dëmin e shkaktuar nga shpifja, përgjegjësia juridike civile për dëmin e shkaktuar nga burgosja me gabim, përgjegjësia juridike civile për dëmin e shkaktuar nga shkelja e të drejtës së autorit dhe të

drejtave tjera nga pronësia industriale e të tjera. Përveç rasteve të lartëpërmendura, përgjegjësia civile mund të lind edhe nga shumë situata tjera që mund të paraqiten në praktikë, qoftë nga sendet e rrezikshme apo veprimtaritë e rrezikshme, por për të gjitha rastet për sajimin e përgjegjesisë do të vlejnjë dispozitat e LMD-së.

KAPITULLI III

III. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL

3.1 Kuptimi i dëmit jomaterial

Bazat e shpërblimit të dëmit jomaterial kanë qenë të njohura që nga e drejta romake, ku pala e dëmtuar përveç shpërblimit të dëmit material, realizonte edhe të drejtën e kompensimit të dëmit jomaterial mbi bazën e vlerësimit të lirë të të gjitha provave nga ana e gjykatësit, duke marr për bazë të gjitha rrethanat specifike të rastit. Kjo e drejtë realizohet përmes përdorimit të padisë *actio iniuriarum*, që aplikohet jo vetëm në rastet e shkeljeve të dinjitetit dhe reputacionit të individit, por edhe me rastin e cënimit të integritetit fizik, sa herë që shkaktoesi i dëmit sillet në mënyrë të gabuar dhe me faj.⁶⁷

Përkundër faktit se disa sisteme juridike të Europës vonë e kanë njohur shpërblimin e dëmit jomaterial, ky koncept në Maqedoni ka qenë i njohur që nga legjislacioni civil i periudhës së mbretërisë SKS, të para luftës së dytë botërore, pjesë e së cilës ka qenë dhe Maqedonia. Këto norma kanë qenë të bazuara në Kodin Civil të Austrisë të vitit 1909 Për dallim nga dëmi material që vjen si rezultat i dëmtimit të të mirave materiale, dëmi jomaterial rezulton nga cënimi i të drejtave jomateriale, siç janë: cënimi i lirisë, privatësisë, nderit, shkaktimi i dhembjeve fizike, psiqike apo të frikës, përkatësisht nga cënimi i të mirave personale të njeriut që i garanton rendi juridik.

Që nga shekulli i XIX, legjislacionet dhe praktika gjyqësore e shumicës së vendeve pranojnë shpërblimin e dëmit jomaterial, në bazë të rregullës së përgjithshme se çdo dëm duhet të shpërblehet, nëse në vetvete ka disa karakteristika të dëmit. Disa autorë, gjatë shek XX mendonin se “dëmi jomaterial ekziston gjithmonë kur kompensimi me para nuk është në gjendje ta kompensojë në mënyrë adekuate dëmin dhe ta vlerësoj objektivisht, pasi paratë në raport me dëmin e shkaktoar nuk mund të plotësojnë funksionin e tyre si ekuivalent.”⁶⁸ Sa i përket emërimit të dëmit jomaterial, autorë të ndryshëm përdorin emërime të ndryshme, si

⁶⁷ R. Zimmermann, “THE LAW OF OBLIGATIONS: Roman Foundations of the Civilian Tradition”, Published in the United States by Oxford University Press Inc., New York, 1996, f.1050-105

⁶⁸ F. Givord, “La Reparation du prejudice moral” I thèse pour le doctorat présentée et soutenue le lundi 14 novembre 1938, à 14 h. Université de Grenoble, Dalloz, Paris.

dëmi jopasuror, dëm për shkak të vdekjes, dëm për shkak të lëndimit trupor apo shëndetit, dëm jo në para, dëm ideal apo dëmi moral, por duhet pasur parasysh se ekuilibrin shpirtëror apo çekuilibrimin nuk i përfshin as termi pasuror e as ai moral, pasi është me element thjesht subjektiv dhe më i saktë do të ishte termi dëm jomaterial.

Dëmi jomaterial sanksionohet në të gjitha legjislacionet nacionale. Kështu edhe neni 189 i LMD parasheh që për shkaktimin e dhembjeve fizike, për vuajtjet shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, shëmtimit, cënimit të reputacionit, nderit, lirisë dhe të drejtave të personalitetit, vdekjen e ndonjë të afërmi si dhe frikës, gjykata nëse vëren se rrethanat e rastit, veçanërisht forca e dhembjeve dhe frikës dhe kohëzgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykoj kompensim të arsyeshëm me para, pavarësisht kompensimit të dëmit material, bile edhe në mungesë të tij. Edhe neni 625 i KC shqiptar parasheh “Personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur ka pësuar një dëmtim të shëndetit ose është cënuar në nderin e personalitetit të tij, është fyer kujtimi i një të vdekuri dhe kërkohet nga bashkëshorti me të cilin ka bashkëjetuar deri në ditën e vdekjes ose nga të afërmit e tij deri në shkallën e dytë, përveç kur fyerja është kryer kur i vdekuri ka qenë gjallë dhe i është njohur e drejta e shpërblimit të dëmit për fyerjen e bërë. Dëmi jomaterial mundë të jetë si pasojë e veprës penale, e veprimit deliktor dhe si pasojë e cënimit të kontratës. Shpërblimi i dëmi jomaterial ka për qëllim që të dëmtuarit ti mundësohet rivendosja e ekuilibrit psikik-emocional që ka ekzistuar para veprimit të dëmtuesit.

Në gjitha vendet e Europës dhe vendet e tjera me demokraci në zhvillim ka një tendencë të zgjerimit të konceptit të dëmit jomaterial, duke përfshirë shkeljen e çdo të drejte subjektive, nisur nga të drejtat themelore të njeriut, siç është e drejta për jetë, reputacion dhe emër të mirë, nderin, pacënueshmërin e shëndetit fizik dhe psikik dhe privatësin. Maqedonia si vend që aspiron të jetë anëtare e Bashkimit Europian, në vazhdimësi bën harmonizimin e legjislacionit të vendit me atë të BE-së, dhe pikërisht këtu synohet edhe zgjerimi i normave mbi shkaktimin e dëmit jomaterial, në dispozitat e Ligjit për Marrëdhënie të Detyrimeve të Maqedonisë, që të përfshihen edhe rrethanat që pamundësojnë ngritjen dhe avancimin në profesion apo karrierë, paaftësinë për të lindur, humbjen e aftësisë seksuale etj. Megjithatë në praktikën gjyqësore paraqiten situata nga më të ndryshmet për gjykim.

Në kuadër të shpërblimit të dëmit jomaterial po përmendim rastin “Peruche”⁶⁹ të lindjes së fëmijës me të meta, të cilat nuk ishin zbuluar gjatë shtatzanisë nga mjekët.⁷⁰ E ëma e fëmijës Jossete Peruche gjatë periudhës së shtatzanisë më 1982, dyshonte të jetë infektuar nga vajza e saj katër vjeçare, të cilës i ishin shfaqur njolla të kuqe që i’a kishin mbuluar gjithë trupin, dhe që u konstatua se bëhet fjalë për fruthin gjerman.⁷¹ Kërkesa e Mrs. Perruche ishte se, në qoftë se ajo do të rezultonte e infektuar, dëshironte më mirë që ta abortoj fëmijën se sa të rrezikoj ta lind të hendikepuar. Zonja Perruche iu nënshtrua dy analizave të gjakut, nga të cilat rezultoi se ajo ishte e sigurt për ta lindur fëmijën. Në fakt, testet kanë qenë kontradiktore. Një test i gjakut më vonë do të tregojnë se mjekët dhe laboratorit i biologjisë kishte bërë një gabim, dhe se në fakt ajo ishte e infektuar. Nga kjo shtatzani më 1983 lindi Nicholas Perruche me shumë të meta, i shurdhër, pjesërisht i verbër dhe me dëmtime të rënda të trurit. Brenda dy viteve, Zonja Perruche nga kjo situatë kishte pësuar një "avari nervore", duke iu nënshtruar përkujdesjes psikiatrike. Edhe djali vazhdon të mbetet nën përkujdesjen e institucioneve për shkak të të metave të tij. Në këtë rast a do të konsiderohet veprimi i mjekut dhe laboratorit të biologjisë si veprim i dëmshëm apo lëshim nga pakujdesia, dhe lindja e fëmijës me të meta a mund të merret si dëm, që prindërit dhe fëmija të fitojnë të drejtën e zhdëmtimit?

- Gjykata konstatoi se prindërit kishin pësuar dëm nga gabimet mjekësore, për shkak të mohimit të të drejtës për ndërprerje të shtatzanisë, dhe se tani ata duhet të kujdesen gjatë gjithë jetës për fëmijën e tyre me hendikep të rëndë.

- Prindërit Perruche u kompensuan në shkurt të vitit 1997, plot pas 13 viteve të procesit gjyqësor. Gjykata vendosi që prindërit e Nicholas të zhdëmtohen për dëmin shkaktuar në rreth \$68.000 dhe një shumë prej \$250.000 për shpenzimet e mëtejshme për përkujdesje ndaj fëmijës.

- Pas apelimit të çështjes, Gjykata e Lartë e Francës (Cour de Cassation) më 17 nëntor të vitit 2000, ia njohu një kompensim edhe më të lartë prindërve dhe fëmijës, shumë e cila nuk është publikuar.

⁶⁹ B. Feuillet, Professor of Law, University Rennes, Member of Institut Universitaire de France “The Perruche case and French medical liability”; Suzanne Daley, “France Bans Damages for ‘Wrongful Births’”, By Published: January 11, 2002 The New York Times.

⁷⁰ Çështja “Peruche”, e vendosur nga Asambleja Plenare e Gjykatës së Kasacionit në Francë më 17 Nëntor të vitit 2000, dhënë për zhdëmtimin për Nicholas Perruche.

⁷¹ Fruthi gjerman, ndryshe quhet “Rubeola”, është infeksion i cili përcillet me skuqje të lëkurës, paraqet rrezik veçanërisht kur paraqitet te gratë shtatzëna, pasi atëherë përcillet edhe tek fëmija përderisa është në mitër, dhe këto fëmijë rrezikojnë që të lindin me të meta të rënda fizike dhe psikike.

• Me ndryshimet e mëvonshme ligjore të miratuara më 4 marsit të vitit 2002 në nenin 114-5 të “Kodit për Veprim Social dhe Familjes” nga Senati Francez se "askush nuk mund të pretendoj për dëmshpërblim vetëm për faktin e lindjes së fëmijës..", dhe në rast të lindjes së fëmijës me aftësi të kufizuar që nuk është zbuluar gjatë shtatëzansisë, për shkak të gabimit apo pakujdesisë së mjekut, mund të kërkojë të dëmshpërblehet vetëm humbjet e tyre, pasi dëmi nuk mund të përfshijë edhe shpenzimet e veçanta që dalin gjatë jetës nga paaftësia e fëmijës nuk mund të kompensohen.

Për dallim nga rasti i lartpërmendur, praktika gjyqësore e Maqedonisë nuk ua njeh të drejtën e zhdëmtimit personave, për rastet që nuk janë paraparë në mënyrë taksative në nenin 189 të LMD-së, edhe pse shpeshherë gjykatësit mundohen që situatat faktike t’ia përshtasin asaj pjese të ligjit që parasheh “për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor”, që të mund të realizon të drejtën në dëmshpërblim pala.

3.1.1 Kushtet e dëmit

Dëmi material mund të përlllogaritet në mënyrë objektive dhe me saktësi të plotë me përdorimin e metodave të përgjithshme dhe operacioneve matematikore, për dallim nga dëmi jomaterial i cili nuk mund saktësisht t’i përcaktohet vlera dhe lartësia e tij, sepse në vete ngërthen ndryshime të brendshme dhe subjektive që dallojnë, varësisht nga personi.

Që të shpërblehet dëmi jomaterial duhet të plotësohen kushte të caktuara. Kushte të caktuara janë:

- që dëmi i shkaktuar ti cenojë vlerat personale të njeriut;
- të ekzistoj faji i të dëmtuarit;
- të ekzistoj intensiteti dhe kohëzgjatja e përjetimit të dhembjeve; dhe
- gjendja material e dëmtuesit.

Dëmi jomaterial - moral, cënon të mirat personale të të dëmtuarit duke zvogëluar aktivitetin njerëzor, duke i shkaktuar shëmtim, frikë, vdekje të të afërmeve e të tjera. Rrethanat e rastit të shkaktimit të dëmit, veçanërisht lartësia (intensiteti) i dhembjeve dhe frikës dhe kohëzgjatja e tyre janë vendimtare në përcaktimin e llojit të dëmit moral dhe vëllimit të tij. Edhe në rastet kur ndonjë personi i vdes një i afërm, konsiderohet se për personat e mbijetuar të familjes së ngushtë, përfshirë bashkëshortin, fëmijët dhe prindërit, u është shkaktuar dëm jomaterial (moral). E njëjta gjë ndodhë edhe në rastet kur vëllezërit dhe motrat e të dëmtuarit,

kanë qenë në bashkësi të përhershme jetësore, me çka konsiderohet se edhe atyre i'u është shkaktuar dëm moral.

Dëmi moral do të shkaktohet edhe në rastet e shkaktimit të invaliditetit të rëndë të ndonjë personi, me të cilin përveç dhembjeve fizike dhe psiqike që krijohen për të dëmtuarin, ky rast gjithashtu krijon dhe dhembje psiqike bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve të të dëmtuarit i cili ka përjetuar invaliditet të rëndë.

Me fjalë të tjera, mund të themi se dëmi moral shkaktohet si pasojë e cënimit të integritetit psikofizik të personit që gëzon në vetvete një mbrojtje juridike, me cilësinë e një të mire materiale, pavarësisht nga zotësia e personit për të krijuar pasuri, ose vlera shkëmbimi.

3.2 Ekzistimi i dëmit

Dëmi ekzistencial shkakton pasoja të ndryshme nga dëmi moral dhe biologjik. Dëmi ekzistencial shkakton pasoja të tilla që nuk lidhen me vlerat ekonomike, por me marrëdhëniet shoqërore, familjare dhe prindërore, dëmton aftësitë kreative, sportive, kulturore, artistike të personit të dëmtuar, dëmton aftësinë e tij për të punuar etj.

Dëmi ekzistencial shkakton ndryshime në rrjedhën normale të jetës së të dëmtuarit të cilat ndikojnë negativisht në personalitetin e tij dhe në veprimtarinë e përditshme duke nxitur në këtë mënyrë një gjendje jo të mirë shëndetësore dhe shpirtërore prej së cilës prodhohet ankth, irritime, depresion, vështirësi për përballimin e situatave jetësore etj.

Që një person që ka kryer faktin e paligjshëm të mbajë përgjegjësi civile, duhet që domosdoshmërisht të jetë shkaktuar dëmi jopasuror në formën e dëmit moral, biologjik apo ekzistencial. Tre figurat e dëmit jopasuror mund të ekzistojnë në mënyrë të pavarur nga njëri tjetri, ose në mënyrë kumulative dhe nga secili prej tyre mund të derivojë e drejta e të dëmtuarit për të kërkuar dëmshpërblimin përkatës. Por, në raste të tilla gjykata duhet të jetë e kujdesshme për të evituar rastet e dëmshpërblimeve të dyfishta. Për të evituar dhënien e dëmshpërblimeve arbitrare duhen përcaktuar parametra matës të tillë të cilët t'i referohen:

- personalitetit të të dëmtuarit;
- interesit të cënuar;
- veprimtarisë së kryer prej të të dëmtuarit;
- ndikimit të veprimit ose mosveprimit të paligjshëm në personalitetin e të dëmtuarit;

3.3 Faji

Për dallim nga përgjegjësia penale ku faji paraqitet si kusht i domosdoshëm për ekzistimin e përgjegjësisë, pa të cilin nuk ka dhe sanksion penal, te përgjegjësia civile faji nuk paraqet kushtin e domosdoshëm të lindjes së përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, sepse te përgjegjësia civile ekzistojnë situata kur përgjegjësia lind edhe pa faj, siç është rasti me përgjegjësinë objektive, që ndryshe quhet përgjegjësia pa faj (përgjegjësia për sendet e rrezikshme dhe veprimtaritë e rrezikshme).

Faji, paraqet elementin e brendshëm subjektiv të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, pasi kjo është një marrëdhënie në mes të vullnetit të dëmtuesit, veprimit të dëmshëm dhe pasojave që shkaktohen nga veprimi i personit. Shkaktuesi i dëmit, kur dëmin e kryen me faj, do të përgjigjet jo për faktin e shkaktimit të dëmit, por për vendimin e tij të brendshëm psikik që ka sjellë në shkaktimin e dëmit. Kështu, nëse dikudh gjuan me gur, me qëllim t'ia thyej xhamin e dritares fqinjit, nuk do të përgjigjet në bazë të rregullave të përgjegjësisë subjektive për shkak të thyerjes së xhamit, por për faktin që ka sjellë në vetvete një vendim të tillë dhe të njëjtin e ka zbatuar në praktik. Dispozitat e ligjit nuk japin kuptimin e fajit, pasi këtë e bën doktrina juridike. Megjithatë, në nenin 141 të LMD-së, vetëm kalimthi përmendet çështja e fajësisë, ku thuhet: “Ai i cili do t’i shkakton dëm tjetrit është i detyruar që ta zhdëmtoj, përderisa nuk është në gjendje ta dëshmon se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”. Në këtë ligj përjashtohen rastet kur dëmi shkaktohet nga sendet e rrezikshme dhe veprimtaritë e rrezikshme, ku subjekti përgjigjet edhe pa faj. Edhe KCSH në nenin 644 thotë “Kur personi që ka kryer veprimin apo mosveprimin e paligjshëm krahas dëmit të shkaktuar, ka pasur edhe një përfitim të dukshëm, gjykata me kërkesën e palës së dëmtuar duke patur parasysh natyrën e dëmit, shkallën e fajësisë e rrethana të tjera të çështjes mund të llogaris në shpërblimin e dëmit, tërësisht apo pjesërisht përfitimin”. Për kuptimin e fajit më gjerësisht do të bëjmë fjalë tek përgjegjësia subjektive. Bazë juridike e përgjegjësisë është faji i suposuar.⁷²

Faji përfaqëson qëndrimin psikik të autorit të dëmit ndaj veprimit të tij dhe pasojës së ardhur. Ky qëndrim shfaqet në dy aspekte të tij: momentin intelektual dhe momentin volitiv⁷³. Momenti intelektual ka të bëjë me mundësinë subjektive për të parashikuar ose jo pasojat që mund të vijnë nga një veprim i caktuar. Kurse momenti volitiv lidhet me dashjen ose mosdashjen e këtyre pasojave të parashikuara. Në funksion të këtyre dy momenteve janë përcaktuar edhe format e fajit që janë:

⁷² A.Jashari, E drejta afariste kontraktore, Tetovë, 2016, faqe. 556.

⁷³ M.Semini, E drejta e detyrimeve dhe e kontratave” Tiranë, 1998

- ✓ dashja dhe
- ✓ pakujdesia.

Dashja- Vetë dashja si formë e fajit, ndahet në dashje direkte dhe dashje indirekte (eventuale). Kështu themi se një person ka vepruar me dashje direkte kur ai parashikon mundësinë e ardhjes së pasojës së dëmshme, e dëshiron ardhjen e saj dhe vepron me qëllim që kjo pasojë të vijë. Faji në formën e dashjes direkte përbën shkallën më të lartë të fajësisë. Për sa i përket dashjes indirekte, autori i dëmit parashikon ardhjen e pasojës nga veprimi i tij, nuk e dëshiron këtë pasojë, por me vetëdije lejon ardhjen e saj.

Pakujdesia- Pakujdesia si formë e fajit dallon nga dashja dhe shfaqet në dy forma: 1) pakujdesia në formën e vetëbesimit të tepruar dhe 2) pakujdesia në formën e neglizhencës. Kur personi përgjegjës ka parashikuar pasojat që mund të vijnë nga veprimi i tij, nuk i dëshiron ato, madje, duke pasur një besim të tepërt në aftësitë e tij, të mjeteve të cilat përdor apo të të tretët, mendon se mund t'i mënjanojë ato; në këtë rast kemi të bëjmë me pakujdesi në formën e vetëbesimit të tepruar. Ndërsa kur personi nuk i parashikon pasojat që mund të vijnë dhe as nuk i dëshiron ato, por kishte detyrimin objektiv dhe mundësinë subjektive për t'i parashikuar, jemi para pakujdesisë në formën e neglizhencës. Kur personi nuk kishte as detyrimin objektiv dhe as mundësi subjektive të parashikonte pasojat, ai ka vepruar pa faj dhe bëhet fjalë për “dëmin e rastit”, rrethanë kjo që e përjashton personin nga detyrimi për shpërblimin e dëmit, pra nga përgjegjësia civile.

3.4 Egzistimi i dhembjeve

Me dhembje fizike nënkuptojmë mundimin, shqetësimin apo vuajtjen që e provon ta heq dikush kur ka dhembje në trup, si rezultat i ndjenjës së pakëndshme të krijuar nga një vuajtje fizike. Dhimbja fizike paraqitet në rolin e mekanizmit mbrojtës të trupit të njeriut dhe kjo shkaktohet çdoherë kur lëndohet ndonjëra nga pjesët e trupit. Edhe përkundër dallimit që ekziston ndërmjet dhembjes fizike dhe dhembjes shpirtërore, prapë se prapë të dyja këto kanë shumë elemente të përbashkëta, duke u nisur nga karakteristika që të dyja këto janë me element të brendshëm subjektiv, ndjenjës së pakëndshme që shkaktohet si dhe efekteve psiqike që krijohen të personi. Sot mjekësia ka arritur që me medikamente mjekësore ta zvogëlojë në minimum dhembjen fizike të personit me rastin e dëmtimeve trupore, por kjo nuk paraqet ndonjë fakt juridik me rëndësi për personin që të humb të drejtën për tu shpërblyer për dëmin trupor të shkaktuar. Ndalimi i shaktimit të dhembjes fizike

sanksionohet edhe në nenin 142 të LMD-së të Maqedonisë, ku jepet përkufizimi për nocionin e dëmit dhe në nenin 189, ku i jepet e drejta gjykatësit të caktojë shpërblimin e dëmit jomaterial në rast të konstatimit të dhembjeve fizike me intensitet të lartë dhe kohëzgjatje më të gjatë, pavarësisht shpërblimit të dëmit material apo mungesës së tij. Dhembja fizike, shkaktohet nga raste të ndryshme të lëndimit trupor, e cila shpeshherë ndodhë edhe nga veprimi i drejtpërdrejtë i personave apo sendeve nga jashtë. Dhembja fizike paraqet një element shumë të rëndësishëm për gjykatësin me rastin e caktimit të shpërblimit të dëmit jomaterial për palën e dëmtuar. Por, për të caktuar një shpërblim të këtillë gjykatësi, duhet të bazohet në raportin e ekspertit gjyqësorë, i cili duhet ta konstatojë se ajo dhembje jo vetëm që është shfaqur, por ka qenë e një intensiteti të lartë dhe me një kohëzgjatje të caktuar, duke marrë për bazë dhe peshën e të mirave të cënuara, me çka duhet të arsyetohet ai shpërblim.

3.5 Realizimi i shpërblimit të dëmit

Realizimi i të drejtës për shpërblim të dëmit, pavarësisht se kush do të jetë përgjegjës, përkatësisht i detyruar për shpërblim të dëmit, bëhet vetëm në qoftëse plotësohen prezumimet procedurale juridike. Kjo do të thotë se personi i dëmtuar nuk do të mund t'a realizojë të drejtën për shpërblim të dëmit me vetë faktin e shkakimit të dëmit, por ai duhet edhe të parashtojë kërkesë për shpërblimin e dëmit. Ndodh kështu, për arsye se realizimi i një të drejte të këtillë bëhet brenda gjykatës dhe, inicimi i një procedimi të tillë gjyqësorë, bëhet vetëm me kërkesë të palës së interesuar. Nuk janë të ralla rastet kur për dëmet e vogla në praktikë realizimi i të drejtës në shpërblim të dëmit të realizohet me marrëveshje në mes palëve, jashta gjykatës pa ndonjë procedurë juridike. Në këto raste, realizimi i të drejtës për shpërblim të dëmit bëhet në vendin e ngjarjes, duke heqë dorë palët nga e drejta për të inicuar procedurë gjyqësore. Në të kundërtën, në qoftëse palët nuk mund të merren vesh për shpërblimin e dëmit, atëherë personi i dëmtuar për të realizuar të drejtën në shpërblim të dëmit, domosdo duhet të ndjekë procedurë juridike të caktuar para gjykatës kompetente.

Shpërblimi për dëmin e shkakuar realizohet në kontestin e veçantë civil. Procedura inicohet vetëm me anë të parashtrimit të kërkesëpadisë nga i dëmtuari (paditësi), me të cilën paraqitet kërkesa konkrete në pikëpamje të shpërblimit të dëmit, faktet ku mbështetet kërkesa, provat dhe vlera e kontestit.

3.5.1 Kërkesa për shpërblim të dëmit

E drejta për realizim të shpërblimit të dëmit të shkaktuar realizohet në procedurë civile. I dëmtuari duhet të parashtrojë kërkesën për shpërblim të dëmit kundër subjektit përgjegjës në gjykatë. Në këto raste, zbatohen rregullat e përgjithshme të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar. Në rastet e tjera, kur dëmi është pasojë e veprës penale, çështja e dëmshpërblimit trajtohet edhe nga gjykata penale. Kjo nuk ndodh përherë kështu, kjo sepse, në rastet kur të vërtetuarit e dëmit civil dhe përcaktimi i lartësisë së tij do ta ngarkojë zhvillimin e procedurës penale, atëherë gjykata e udhëzon të dëmtuarin që të ndjekë procedurë të veçantë kontestimore civile, me qëllim të realizimit të shpërblimit të dëmit. Në rastet kur dëmi është pasojë e veprës penale, nuk do të thotë që gjykata civile përherë të jetë e lidhur me vendimin e gjykatës penale lidhur me veprën penale dhe përgjegjësinë penale, por ajo vendos fare lirë dhe në mënyrë të pavarur nga ky ndikim, në qoftëse vërteton se plotësohen kushtet për ekzistencën e përgjegjësisë juridike civile, atëherë do të sjell vendim për ta detyruar dëmtuesin për shpërblim të dëmit, edhe sikur gjykata penale ta kishte liruar atë nga përgjegjësia penale.⁷⁴

Kërkesa për realizim të shpërblimit të dëmit ngrihet vetëm kundër subjektit përgjegjës, pasi vetëm dëmi i shkaktuar nga ky subjekt paraqet bazë për ngritjen e kërkesëpadisë. Në këtë rast, gjykatësi është i lidhur për kërkesën e palës, dhe të njëjtën mund ta shqyrtojë deri në kufijtë e kërkesës që është parashtuar në procedurë. Përveç parashtrimit të padisë, çështje të tjera që duhet të plotësohen janë, kushtet dhe baza e përgjegjësisë juridike civile për dëmin e shkaktuar, që do të thotë se i dëmtuari duhet të kryejë një sërë veprimesh procedurale për të realizuar të drejtën e tij. Paditësi, paraprakisht duhet të provojë se është shkaktuar dëmi si rezultat i veprimeve të drejtpërdrejta apo të tërthorta të të paditurit, nën ndikimin e rrethanave të caktuara dhe të ofroj prova të mjaftueshme për fajësinë e palës së paditur, kur dëmin e ka shkaktuar me dashje. Parashtrimi i kërkesës nga ana e të dëmtuarit ose nga i autorizuari i tij, duhet të bëhet brenda afateve të përcaktuara nga ligji.

3.5.2 Parashkrimi i kërkesës për shpërblim të dëmit

Te shpërblimi i dëmit në marrëdhëniet juridike civile, i rëndësisë së veçantë është edhe institucioni i parashkrimit. Rregullativa e institucionit të parashkrimit është materie

⁷⁴ N.Dauti, E drejta e detyrimeve, Prishtinë, 2001, faqe. 197, 198.

ligjore.⁷⁵ Parashkrimi është një fakt juridik i kategorisë së ngjarjeve me vërtetimin e të cilit vijnë pasoja me natyrë shuese, pasoja këto të lidhuar me të drejtën subjektive të përdorimit të njërit prej mjeteve bazë dhe më të rëndësishme të mbrojtjes së të drejtave civile – padisë.⁷⁶ Insituti i parashkrimit është i vetmi institut që kufizon nga pikpamja e kohës realizimin e një të drejte me anë të forcës shtërnguese të gjykatës, apo të organeve tjera shtetërore. Parashkrimi përmban dy elemente të rëndësishme: kalimin e kohës dhe vullnetin e njeriut. Kalimi i një kohe të përcaktuar nga ligji është koha e cila përbën atë që quhet afat parashkrimi. Ky afat caktohet me norma urdhëruese nga vet ligji në interes të vet personit që mendon se i është cënuar një e drejtë, afat ky i arsyeshëm për të justifikuar interesin e personit për realizimin e të drejtës së tij. Vet kalimi i kohës nuk çon deri te parashkrimi, por e nevojshme është që asaj t'i bashkangjitet vullneti i subjektit në interesin e të cilit rrjedh koha. Pa faktorin e dytë – vullnetin e subjektit, ngjarja faktike nuk mund të fitojë përmbajtje juridike dhe të shndërrohet në të drejte. Ajo ngjarje për shkak të humbjes së mekanizmit mbrojtës me anë të sanksionit, pushon të jetë marrdhënie juridike dhe bëhet detyrim natyral. Kjo do të thotë se titullari i të drejtës subjektive të parashkruar nuk ka të drejtë që t'i drejtohet gjykatës me padi në kuptimin formal.

Parashkrimi zbatohet në pjesën më të madhe të marrëdhënieve pasurore. Rregullat e parashkrimit gjejnë zbatim në të gjitha marrëdhëniet juridike civile pa marrë parasysh burimin e detyrimeve, ligjin apo aktet me të cilat është rregulluar ajo marrëdhënie. Detyrimi mund të rezultoi nga kontrata, shprehja e njëanshme e vullnetit, shkaktimi i dëmit, fitimi i pabazë apo gjërimi i punëve të huaja pa porosi. Nga kjo kategori bëjnë përjashtim vetëm ato marrëdhënie pasurore për të cilat e drejta e padisë në mënyrë të shprehur përcaktohet nga ligji si e paparshkrueshme.

Në bazë të aktgjykimit me cilësinë e dokumentit ekzekutiv, i dëmtuari e realizon shpërblimin e dëmit. Specifika e shpërblimit të dëmit, mund të realizohet në qoftë se i dëmtuari, brenda afateve ligjore të përcaktuara i ndërmerr masat e nevojshme juridike. Në qoftë se skadojnë ato afate, atëherë vjen në shprehje aplikimi i parashkrimit. Me parashkrimin, të dëmtuarit i pushon e drejta për të kërkuar mbrojtje gjyqësore për shpërblim të dëmit. Pra, e rëndësishme është koha-afati brenda të cilit mund të kërkohet shpërblimi i dëmit nga ana e organeve të gjyqësisë. Me fjalë të tjera, që të lind parashkrimi është e nevojshme që një e drejtë subjektive civile të mos ushtrohet dhe të ketë kaluar një kohë që ajo e drejtë të mos jetë ushtruar.

⁷⁵ Nenet 349-369 të LMD-së.

⁷⁶ N.Ardian, Leksione të së drejtës civile, Tiranë, 2004, faqe. 171, 522.

Kërkesa për shpërblim të dëmit, parashkruhet për tre vite nga momenti kur i dëmtuari ka kuptuar për dëmin dhe për personin që e ka shkaktuar dëmin afati subjektiv, dhe për pesë vite nga momenti kur dëmi është shkaktuar – afati objektiv.⁷⁷

Afatet e parashkrimit prodhojnë veprim të plotë juridik vetëm atëherë kur e drejta subjektive civile nuk ushtrohet tërësisht. N.q.s. titullari i ka shfrytëzuar të drejtat në atë mënyrë në bazë të së cilës mund të shihet ushtrimi i të drejtës atëherë parashkrimi ndërpritet. Ka raste kur edhe e drejta nuk ushtrohet por parashkrimi nuk rrjedh. Këtu bëhet fjalë për pezullimin e parashkrimit.⁷⁸

Më në fund, nga momenti kur fillon parashkrimi dhe deri te skadimi i afatit të paraparë për parashkrim, nënvizojmë këtu paraqitjen e ndërprerjes apo ndaljes së parashkrimit. Parashkrimi ndalet në të gjitha punët ku shihet ushtrimi i të drejtës edhe atë si nga ana e titullarit të së drejtës, ashtu edhe nga personat tjerë. Ashtu ndërprerje të parashkrimit paraqitet me parashtrimin e padisë në gjykatë. Si moment i ndaljes së parashkrimit merret ai moment kur padia i është dorzuar gjykatës.⁷⁹ N.q.s. padia tërhiqet prap, atëherë llogaritet se parashkrimi nuk është ndalur.

Është me rëndësi të përmendet se nuk ndodhë ndërprerja e parashkrimit të kërkesës për shpërblim të dëmit me momentin e zhvillimit të procedurës penale, kur procedura penale ka përfunduar në mënyrë të plotfuqishme me aktgjykim lirues në të cilën janë paraqitur kërkesa pasurore – juridike.

Gjyqësia e Maqedonisë ka bërë dallimin midis ndërprerjes së parashkrimit të kërkesës për shpërblim të dëmit të shkaktuar me vepër penale, e cila vepër nuk është vërtetuar në procedurë gjyqësore, pra është sjellur aktgjykim lirues. Në rastin e parë, kur me aktgjykim të plotfuqishëm në procedurë penale vërtetohet vepra penale, përkatësisht kur kërkohet shpërblimi i dëmit të shkaktuar me vepër penale, parashkrimi ndërpritet për kërkesën që i referohet shpërblimit të dëmit.

3.5.3 Vendimi mbi shpërblimin e dëmit

Gjykata me kujdes të veçantë do të vendosë që shpërblimi i dëmit t'i përgjigjet në mënyrë adekuate pasojës së shkaktuar. Vendimi për shpërblimin e dëmit nuk duhet të paraqes pasurim të të dëmtuarit, e as imponim të varfërisë të subjektit përgjegjës. Vendimi gjyqësor,

⁷⁷ Neni 365, pika 1 dhe 2 e LMD-së.

⁷⁸ Krahaso arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, Rev.nr. 429/07.

⁷⁹ S. Voislav, vep. e cit. faqe. 322.

përkundrazi duhet të pasqyrojë qëllimin e shpërblimit të dëmit, të evitohet pasojat e dëmshme dhe të krijojë gjendjen që ka ekzistuar të dëmtuari para shkakimit të dëmit. Shpërblimi i dëmit material duhet t'i afrohet sa më shumë ekuivalencës së lartësisë së pasojës së shkakuar. Kurse, shpërblimi i dëmit jomaterial duhet t'i mbrojtë vlerat personale, të drejtat e njeriut e të tjera. Këto, në mënyrë precize, duhet t'i përmbajë dispozitivi i vendimit gjyqësor. Varësisht nga rasti dhe situatat e shkakimit të dëmit material, gjykata duhet të vendos që shpërblimi i dëmit material të realizohet ose me kthim në gjendjen e mëparshme ose me shpërblim në të holla të dëmit. Gjatë vendosjes për shpërblimin e dëmit, gjykata ka rol aktiv dhe vëmendje të veçantë shpreh edhe në caktimin e lartësisë të shpërblimit të dëmit në të holla, sidomos në vërtetimin e rrethanave që ndikojnë në lartësinë e këtij shpërblimi. Në këtë kontekst, dëmi, faj, gjendja pasurore e subjektit përgjegjës dhe e të dëmtuarit dhe faktet e tjera janë çështje që kanë efekt të drejtpërdrejtë në përmbajtjen e vendimit gjyqësorë mbi shpërblimin e dëmit. Gjkata, poashtu duhet të merr parasysh rrethanat të cilat janë shkakuar pas shkakimit të dëmit. Ajo duhet të gjykojë shpërblimin në shumën që është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të arrij atë nivel që e ka pasur përpara shkakimit të dëmit. Gjatë vlerësimit të lartësisë së fitimit të humbur, gjykata duhet të sjellë asisoj vendimi, i cili do të marr parasysh fitimin, të cilin nuk e ka realizuar i dëmtuari për shkak të shkakimit të dëmit, që përndryshe sipas rrjedhës të zakonshme të gjërave do ta realizonte. Në rastet e gjykimit të shpërblimit të dëmit jomaterial, gjykata duhet të sjellë vendim që do të zhdëmtojë të dëmtuarin me të holla apo përjashtimisht me kthim në gjendje të mëparshme. Gjatë vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jomaterial, gjykatësi merr për bazë rëndësinë e të mirës së cënuar dhe qëllimin e shpërblimit të dëmit, pasi me kujdes të veçantë duhet të vërtetojë edhe gjendjen faktike dhe rrethanat e tjera për zgjidhjen e kontestit. Faktet dhe provat i ofrojnë palët në proces dhe vetë gjykata, ndërkaq çmuarjen e provave qoftë kur gjykohet për dëm material apo për dëm jomaterial e bën vetëm gjyqtari në mënyrë të lirë për çdo rast konkret. Në rastet kur vendimi i gjykatës për shkak të shpërblimit të dëmit do të jetë pozitiv, për të dëmtuarin atëherë vendimi gjyqësorë duhet të përcaktojë të drejtën për shpërblimin konkret të dëmit, sipas të gjitha formave të parapara me ligj. Vendimi i formës së prerë gjyqësor për shpërblimin e dëmit, e ka cilësinë e titullit ekzekutiv.

KAPITULLI IV

IV.RASTET E SHPËRBLIMIT TË DËMIT JOMATERIAL

1. Rastet e shpërblimit të dëmit jomaterial në vitin 2015

Në vitin 2015 janë analizuar 30 vendime gjyqësore që kanë të bëjnë me shpërblimin e dëmit jomaterial. Në disa prej tyre dëmi ka qenë rezultat i fyerjes, në disa prej tyre dëmi është rezultat i vuajtjeve psikike, dhembjeve fizike, shëmtimit dhe në disa dëmi jomaterial është rezultat i frikës. Fillimisht prezentojë përmbledhje të të gjitha vendimeve, kurse mandej bëjë prezentimin e vendimeve gjyqësore ku është refuzuar kërkesa për dëmshpërblim me preteks se nuk ka dëshmi të mjaftueshme në lidhje me përmbushjen e kushteve ligjore për dëmshpërblim. Dhe në fund prezentojë në mënyrë të ndarë vendimet gjyqësore varesisht nga shkakut për dëmshpërblim.

	Nr. Vendimit	Data	Paditësi	I padituri	Objekti	Shuma	
1	XXXII P4-898/15	17.12.2015	J.K	Shoqëri akcionre E.O.S . Shkup	Shpërblim i Dëmit jomaterial përshkak të shkeljes së të drejtave personale	376.000,00	Den
2	8ok P5-6/15	03.04.2015	S.Gj	D.D	Shpërblim i dëmit jomaterial për shkakë feyrjes së nderit dhe reputacionit	30.000,00	Den
3	9 MALLVP-1429/15	20.11.2015	V.J	SH.A sigurimi SAVA Shkup	Shpërblim i Dëmit jomaterial përshkak të shkeljes së të drejtave personale	105.000,00	Den
4	VIII o P4-717/14	18.09.2015	M.A	Shoqëria për shërbime Media Print Maqedoni SH.P.K.1	Shpërblim i dëmit jomaterial për fyerje dhe shpifje	500	Euro
5	VIII P4-436/14	19.05.2015	D.P.LL	S.I dhe shoqëria për produksion SH,P,K.1	Shpërblim i dëmit jomaterial për fyerje dhe shpifje	35.000,00	Den
6	VIIIk P5-51/14	07.12.2015	D.N	E.V-N	Kompensimi i Shpenzimeve të procedurës gjyqësore	35.620,00	Den
7	VIII P4-695/14	19.05.2015	D.P.LL	S.I	Shpërblim i dëmit jomaterial për fyerje dhe shpifje	20.000,00	Den
8	XI P4- 492/14	20.10.2015	ZH.M	M.C	Kompensimi i Shpenzimeve të procedurës gjyqësore	43.872,00	Den
9	17 P4-1797/14	18.02.2015	A.B.	SH.A për sigurim INSING- Maqedonija Shkup	Shpërblim i dëmit jomaterial	120.000,00	Den
10	VIII ok P5-21/15	09.12.2015	A.A	M.B	Kompensimi i Shpenzimeve të procedurës gjyqësore	13.192,00	Den

11	XXXIV P4 nr.577/13	11.02.2015	Z.R dhe O.R	Shoqëri akcionre ndërtimore ILINDEN	Shpërblim i dëmit jomaterial përshkak të vuajtjeve psiqike	700.000,00	Den
12	9 P4-1048/15	02.11.2015	N.A dhe I. A	Shoqëria akcionre për sigurim INSING MAQEDONIA SH.A Shkup	Shpërblim i Dëmit jomaterial përshkak të shkeljes së të drejtave personale	65.000,00	Den
13	XIV MALLVP- 1271/15	11.12.2015	J.A	I.S dhe R.G	Shpërblim i dëmit jomaterial	125.000,00	Den
14	11 P4-1117/13	15.07.2015	V.B	Shoqëria akcionare per sigurim Triglav Shkup	Kompensimi i Shpenzimeve të procedurës gjyqësore	14.160,00	Den
15	19 P4-1511/14	06.02.2015	D. N	Sigurimi SAVA SH.A Shkup	Shpërblim i Dëmit jomaterial përshkak të shkeljes së të drejtave personale	350.000,00	Den
16	16 P4-1401/14	03.04.2015	F.B	Shoqëria akcionare per sigurim Triglav Shkup	Shpërblim i Dëmit jomaterial përshkak të shkeljes së të drejtave personale	63.000,00	Den
17	XXXI. P4.nr.583/15	03.07.2015	Z.G	KO SH.A Shkup	Shpërblim i Dëmit jomaterial përshkak të shkeljes së të drejtave personale	360.000,00	Den
18	XI P -667/14	12.06.2015	V.T	G.M	Kompensimi i Shpenzimeve të procedurës gjyqësore	35.895,00	Den
19	XI P5 nr.32/14	06.04.2015	SH.A Telekom ii Maqedonis Shkup	S.G	Kompensimi i Shpenzimeve të procedurës gjyqësore	34.660,00	Den
20	VIII P4-283/14	11.09.2015	V.T	Shoqëria për shërbime Media Print Maqedonija SH.P.K.1	Kompensimi i Shpenzimeve të procedurës gjyqësore	233.179,00	Den
21	XI P4-827/14	28.05.2015	Komuna e Karposhit	M.N	Kompensimi i Shpenzimeve të procedurës gjyqësore	26.690,00	Den
22	VIII.P5-26/14	23.04.2015	Avokat ZH.B	J.C	Kompensimi i Shpenzimeve të procedurës gjyqësore	17.940,00	Den
23	XXXVII P4 nr. 683/15	07.07.2015	V.V	SH.A Sigurimi Triglav Shkup	Kompensimi i Shpenzimeve të procedurës gjyqësore	16.520,00	Den
24	XIV. MALLVP- 1034/15	05.11.2015	V.L	SH.A Sigurimi Euroins Shkup	Shpërblim i Dëmit jomaterial përshkak të shkeljes së të drejtave personale	56.000,00	Den
25	15 P4-1377/14	10.11.2015	F.F	R.C	Shpërblim i Dëmit jomaterial përshkak të shkeljes së të drejtave personale	70.000,00	Den
26	11 P4-231/14	04.05.2015	A.K	Z.T	Shpërblim i Dëmit	170.000,00	Den

					jomaterial përshkak të shkeljes së të drejtave personale		
27	XXXII P4-804/15	15.11.2015	F.D	SH.A Sigurimi Euroins Shkup	Shpërblim i Dëmit jomaterial përshkak të shkeljes së të drejtave personale	180.000,00	Den
28	9 P4-1386/13	14.07.2015	B. D. etjer	SH.A për prodhimin e energjis elektrike Elektrana e Maqedonis në pronsi te Shtetit ELEM	Shpërblim i dëmit jomaterial përshkak të vuajtjeve psiqike	1.300.000,00	Den
29	16 P4-103/15	19.05.2015	H.K	Shoqëria për sigurim UNIKA SH.A Shkup	Shpërblim i Dëmit jomaterial përshkak të shkeljes së të drejtave personale	153.000,00	Den
30	X XVIII P4-2103/14	27.03.2015	H.Z	Grupi i Sigurimeve Kombëtare SH.A POLISA E SIGURIMIT Shkup	Shpërblim i Dëmit jomaterial përshkak të shkeljes së të drejtave personale	112.000,00	Den

Përmbledhja e vendimeve të analizuara në vitin 2015

Numri i vendimeve të analizuar viti 2015	Numri i vendimeve pjesërisht të miratuara	Numri i vendimeve të refuzuara	Numri i vendimeve me kamatë	Numri i vendimeve pa kamatë	Shuma në denar	Shuma në euro
30	20	10	20	10	4.906.728,00	500 EUR

Nga 30 vendimet e analizuara të vitit 2015, pjesërisht të miratuara janë 20 dhe 10 janë të refuzuara, mënyra e shpërblimit të dëmit jomaterial te vendimet pjesërisht të miratuara është në para me kamatë ligjore e bazuar në lartësinë e shkallës së referencës së Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, e cila ishte e vlefshme në ditën e fundit të gjysëmvetorit që i ka parapri periudhës aktuale gjashtëmujore.

Arsyet e vendimeve të refuzuara gjatë vitit 2015:

- **VIIIk P5-51/14** – Gjykata mori vendim që të hedh poshtë padinë për arsye se e paditura të gjithë atë që e ka parashtruar para organeve kompetente nuk ka pasur qëllim të dëmtoj nderin dhe autoritetin e tij por të realizoj të drejtat e saja si nënë dhe të mbroj intereset e fëmijës. Për atë edhe gjykata vërtetoi se nuk janë të plotësuar kushtet e nenit 8 të Ligjit për përgjegjësi civile për fyerje dhe ofendim.
- **XI P5-42/14** – vendimi u refuzua si i pabazuar përshkak se gjykata pranoi se lirija e shprehur e të paditurit në këtë rast rrjedh prej dispozitave të ligjit mbi përgjegjësin civile për fyerje dhe shpifje, këtë të drejt nuk e përjashton neni 10 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Në këtë mënyrë gjykata vendosi të refuzoj padinë si të

pabazë, pasi është përcaktuar nga dëshmit që nuk ka pasur shkelje të përgjegjësive civile për fyerje dhe shpifje nga ana e të paditurit.

- **VIII ok P5-21/15** – vendimi u refuzua i pabazuar pasi nuk plotësohen kushtet e nenit 6 të Ligjit për Përgjegjësi Civile për Fyerje dhe Shpifje, gjithashtu nuk pranohen edhe kushtet e nenit 187-a-194 të LMD. Në bazë të këtyre neneve, në rastin konkret gjykata duke marrë parasysh të gjitha vendimet konstaton se nuk ka llogaridhënje në padinë që është parashtruar.
- **11 P4-1117/13** – nga shqyrtimi i provave të paraqitura, duke analizuar dokumentacionin e përgjithshëm vërtetohet se padia e paditësit është e vjetruar, dhe si e tillë është refuzuar si e pabazuar. Shkaku i refuzimit të kësaj padie është afati i vjetërsimit të kërkespadi, pasi që padia është ngritur me 17.07.2013, ndërsa aksidenti ka ndodhur me 19.08.2006, që sipas nenit 365 të Ligjit mbi Mardhëniet Detyrimore kjo kërkespadi është e vjetruar.
- **XI P4 667/14** – refuzimin e këtij vendimi gjykata e hodhi poshtë si të pabazë sepse u vërtetua se nga dëshmit e paraqitura nuk ka shkallë të përgjegjësive civile për shpifjen e të pandehurit në bazë të nenit. 8 paragrafi.1 dhe 3 të këtij ligji, pasi i pandehuri nuk ka nxjerr fakte të rrejshme që mund të shkelin të drejtat personale për paditësin.
- **XI P5 nr.32/4** – arsyeja e refuzimit u nxjerr nga dëshmit dhe përmbajtja e plotë e deklaratave dhe periudha në të cilën janë dhënë deklaratat, se i padituri ka pasur qëllim t'i ofroj opinionit tema me karakter publik dhe informacione të cilat shoqëri ka të drejtë ti pranojë në një shoqëri demokratike, dhe se nuk ka pasur qëllim të nxjerr fakte të pavërteta dhe të dëmtoj autoritetin e tij.
- **VIII P4-283/14** – shkaku i refuzimit të kësaj kërkespadi është se gjykata konstaton se të padituri V.K. nuk ekziston përgjegjësi për fyerje dhe është përjashtuar nga përgjegjësia për shpifje, duke pasur parasysh se nuk ka dhënë deklaratat para personave të tret me qëllim që të dëmtoj nderin dhe autoritetin e tij, por që të parashtror pyetje si këshilltar në këshillin e Komunës së Manastirit, duke shfrytëzuar ligjitimitetin e tij.
- **P4-827/14** – kërkespadi është refuzuar përshkak se provat e paraqitura dëshmojnë se nuk ka ndonjë shkallë të përgjegjësive civile për shpifje duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1 dhe paragrafi 3 të ligjit të përgjegjësive civile, dhe gjykata është e mendimit se padia për përcaktimin e përgjegjësive së të pandehurit për shpifje për shkak të shkeljes së nderit është e pabazuar, pasi e njëjta nuk ka bazë në ligjin në fjalë. Kjo përshkak se paditësi i Komunës së Karposhit ka statusin e personit juridik dhe si i tillë nuk ka të drejtë personale të nderit pasi këtë të drejtë e kanë vetëm personat fizikë.
- **VIII. P5-26/14** – nga gjendja faktike e vërtetuar gjykata nxori kërkespadin si të pabazë për arsye se nuk janë të plotësuar elementet për përgjegjësi civile që përcakton neni 8 paragrafi. 1 ku thotë se për të pasur përgjegjësi për ofendim duhet të ketë si element kyç faktet e trilluara dhe qëllimin e dëmtimit që në këtë rast konkret nuk janë plotësuar.
- **XXXVII P4 nr. 683/15** – arsyeja e refuzimit të këtij vendimi vjen duke u mbështetur nga raporti i ekspertëve të trafikut të përgaditur nga tre ekspertë përmes institutit për ekspertizë, që me deklaratën e tyre të dhënë para kësaj gjykate konfirmuan gjendjen faktike të vërtetuar se i vetmi fajtor për ndodhjen e aksidentit të trafikut dhe për pasojat e dëmit është vetë paditësi, që ka hyrë në drejtim të kundërt të rrugës, dhe gjykata konstaton se paditësi në rastin konkret edhe pse është i lënduar, nuk ka bazë për një pretendim të dëmit pasuror dhe jopasuror, duke pasur parasysh se ai është fajtor për ndodhjen e aksidentit dhe sipas kësaj nuk ka të drejtë për të kërkuar dëmshpërblim sipas rregullave të detyrimit në rastin e aksidentit të shkaktuar nga mjetet motorike në lëvizje.

2. Rastet e shpërblimit të dëmit jomaterial në vitin 2016

Në vitin 2016 janë analizuar 30 vendime gjyqësore që kanë të bëjnë me shpërblimin e dëmit jomaterial. Në disa prej tyre dëmi ka qenë rezultat i fyerjes, në disa prej tyre dëmi është rezultat i vuajtjeve psikike, dhembjeve fizike, shëmtimit dhe në disa dëmi jomaterial është rezultat i frikës. Fillimisht prezentojë përmbledhje të të gjitha vendimeve, kurse mandej bëjë prezentimin e vendimeve gjyqësore ku është refuzuar kërkesa për dëmshpërblim me preteks se nuk ka dëshmi të mjaftueshme në lidhje me përmbushjen e kushteve ligjore për dëmshpërblim. Dhe në fund prezentojë në mënyrë të ndarë vendimet gjyqësore varesisht nga shkaku për dëmshpërblim.

	Nr. Vendimit	Data	Paditësi	I padituri	Objekti	Shuma	
1	8k P5-11/16	31.10.2016	S.S	M.N	Kompensimi i Shpenzimeve të procedurës gjyqësore	31.720,00	Den
2	8k P5-60/15	27.10.2016	D.S etj.	B.S	Shpërblim i dëmit për shkakë feyrjes së nderit dhe reputacionit	30.000,00	Den
3	11 P4 - 2058/14	16.02.2016	V. N.	N.P Rrug dhe Rrugica dhe Qyteti i Shkupit	Shpërblim i dëmit jomaterial përshkak të shkeljes së shëndetit fizik dhe mendor	85.000,00	Den
4	8ok P5-28/15	07.11.2016	A.P.D dhe B.D	A.C dhe Shoqëria tregtare transmetuese SH,P,K	Shpërblim i dëmit jomaterial për shkakë feyrjes së nderit dhe reputacionit	180.000,00	Den
5	XI P5-26/15	26.04.2016	B.J	M.N	Shpërblim i dëmit për shkakë feyrjes së nderit dhe reputacionit	40.000,00	Den
6	2 II5-10/16	14.10.2016	F.D e tjer	F.LL e tjer	Shpërblim i dëmit jomaterial për shkakë të vuajtjeve psikike	12.000,00	Den
7	VIII ok P5-62/15	30.03.2016	.B.B	B.F	Shpërblim i dëmit jomaterial për fyerje të nderit dhe shpifje	250.000,00	Den
8	V III-o P4-685/14	14.10.2016	B.J	S.J	Kompensimi i Shpenzimeve të procedurës gjyqësore	47.282,00	Den
9	VIII ok P5-53/14	22.03.2016	P.B	LL.D	Kompensimi i Shpenzimeve të procedurës gjyqësore	27.305,00	Den
10	VIII ok P5-46/15	02.11.2016	G.T	A.S	Kompensimi i Shpenzimeve të procedurës gjyqësore	83.142,00	Den
11	VIII MALLVP-1786/15	15.02.2016	B.S	Z.M	Shpërblim i Dëmit jomaterial për shkeljen e të drejtave personale	105.000,00	Den
12	38 P4-749/16	26.07.2016	T.M	T..	Shpërblim i Dëmit jomaterial për shkeljen e të drejtave personale	120.000,00	Den
13	16 P4-1273/15	03.11.2016	SH.A. EVN e M.	Z.O	Kompensimi i Shpenzimeve të procedurës gjyqësore	23.400,00	Den

14	3mv MALVP-1922/15	01.04.2016	D.A	Shoqëria akcioner për Sigurim EUROLINK Skopje	Shpërblim i Dëmit jomaterial për shkeljen e të drejtave personale	115.000,00	Den
15	16. MALLVP-689/16	17.10.2016	V.N	Shoqëria për Sigurim A. SHA	Shpërblim i Dëmit jomaterial për shkeljen e të drejtave personale	60.000,00	Den
16	X XXII P4-1888/15	03.02.2016	E.B	T.K	Shpërblim i Dëmit jomaterial për shkeljen e të drejtave personale	110.000,00	Den
17	X XXII P4-1451/15	13.10.2016	Xh. Xh	Shoqëria për sigurim UNIKA SH.A Shkup	Shpërblim i Dëmit jomaterial për shkeljen e të drejtave personale	102.300,00	Den
18	17 MALLVP-1431/16	07.11.2016	S. R	Sh.A Sigurimi Trigla	Shpërblim i Dëmit jomaterial për shkeljen e të drejtave personale	10.000,00	Den
19	11 P4 - 1513/15	05.02.2016	D .R	Shoqëria për sigurim Shkup	Shpërblim i Dëmit jomaterial për shkeljen e të drejtave personale	60.000,00	Den
20	XXV.P4. nr.1802/15	21.04.2016	D.S	T.O. SHA	Shpërblim i Dëmit jomaterial përshkak të vuajtjeve të vazhdueshme psiqike	250.000,00	Den
